



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:
“Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”
ofruar nga
Universiteti “Western Balkans”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Genci Sharko

Dr. Odeta Shkreli

Tetor / 2025

Tabela Përmbledhëse e të Dhënave të Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Shkenca Kompjuterike Dhe Inteligjencë Artificiale”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Western Balkans”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departmenti i Shkencave Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr. 416, datë 14.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 (tre) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022 – 2023: 10 PAE / 8 PAK 2023 – 2024: 11 PAE / 3 PAK 2024 – 2025: 11 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	2022 – 2023: 11 studentë 2023 – 2024: 6 studentë 2024 – 2025: 30 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Western Balkan është themeluar në vitin 2021 me VKM Nr. 697, datë 10.11.2021.

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” përfshihet në ciklin e parë të studimeve universitare të ofruara nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Infovacionit, Universiteti Western Balkan dhe është liçencuar me Urdhërin Nr. 416, datë 14.07.2022. Vlerësimi i jashtëm për qëllim të akreditimit po realizohet për herë të parë bazuar në kërkesën e Rectorit të Universitetit Western Balkan për aplikim për akreditimin e programeve të studimit drejtuar ASCAL-it, me datë datë 27.05.2024, Nr. 240/1 Prot.

Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve në 180 kredite ECTS, ku në përfundim të tij përfitohet Diplomë Universitare Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”.

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” është i hartuar dhe zbatohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike duke harmonizuar të gjithë komponentët e tij në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimet dhe misionin e universitetit dhe departamentit. Qëllimi i këtij programi studimi është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dijet me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në fokus të programit është të përgatisë studentë të aftë në programim, inovacion, mendim kritik dhe analitik, zgjidhjen e problemeve të ndryshme si dhe të jenë të aftë të japin kontributin e tyre në shoqëri.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM Nr. 109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”.

Grupi i vlerësimit të jashtëm i ngritur për vlerësimin e programit të studimit përbëhet nga: **Prof. Dr. Genci Sharko dhe Dr. Odeta Shkreli**. Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), Z. Muhamed Prezja.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Shkurt 2025 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Western Balkan (WBU) për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. WBU, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur në RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht në kërkesat e parashikuara nga Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Gjatë vizitës së kryer në institucion u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të universitetit. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si auditorët, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti "Western Balkans" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.09.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 24/35 Prot, datë 23.09.2025. Universiteti "Western Balkans" përcjell në ASCAL më datë 02.10.2025, nëpërmjet shkresës me nr.637 Prot, datë 29.09.2025 “Kthim përgjigje mbi komentet e Draft – Raportit”. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Në lidhje me komentin e Standardit I.2 / Kriteri 2, konkluzione;

Përgjigje nga GVJ: GVJ vlerëson iniciativën që Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe njësia kryesore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në “Universiteti Western Ballkan” ka ndërmarrë për marrëveshje strategjike me “Durana Tech Park” në lidhje me



bashkëpunimin afatgjatë në mbështetje të objektivave të programit të studimit. Duke qene një marrëveshje në proces, si dhe pamundësia në verifikimin e kësaj marrëveshje nga GVJ , ajo mbetet e mendimit të vlerësimit të dhënë në draft. GVJ konkludon që **RVJ nuk ndryshon.**

2. Në lidhje me komentin e Standardit I.2 / Kriteri 3;

Përgjigje nga GVJ: GVJ vlerëson se manuali EPIC me përmbajtjen aktuale në formë të përgjithshme nuk është përshtatur për fushës se mbulimit të programit të studimit “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”.GVJ konkludon që **RVJ nuk ndryshon.**

3. Në lidhje me komentin e Standardit IV.1 / Kriteri 1;

Përgjigje nga GVJ: GVJ vlerëson pozitivisht angazhimin e institucionit për përmirësimin e sistemit të brendshëm të menaxhimit, i cili synon të mundësojë administrimin më efektiv të ngarkesave mësimore dhe angazhimit të stafit akademik. Nismat e ndërmarra në këtë drejtim tregojnë përkushtimin e institucionit ndaj garantimit të cilësisë dhe përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe standardet akademike. Megjithatë, duke qenë se gjatë procesit të vlerësimit janë konstatuar mospërputhje ndërmjet të dhënave të raportuara në dokumentacionin zyrtar, GVJ i qëndron rekomandimit të dhënë. GVJ konkludon që **RVJ nuk ndryshon.**

4. Në lidhje me komentin e Standardit IV.1 / Kriteri 1;

Përgjigje nga GVJ: GVJ e sheh pozitivisht dhe mbështet angazhimin e ekspertëve nga industria, të cilët kontribuojnë në pasurimin e procesit mësimor. Gjithashtu, qartësojmë se GVJ nuk ka bërë asnjë vlerësim kritik mbi angazhimin e personelit me gradë MSc në mësimdhënie, por ka konstatuar mospërputhje në të dhënat e raportuara mbi personelin e angazhuar, të reflektuara në dokumenta të ndryshme (syllabuse, tabelat përmbledhëse, raportet vjetore), dhe ka sugjeruar që ky raportim të jetë i qartë dhe koherent në të gjitha burimet. Nga ana tjetër, për disa lëndë, lektorët e përcaktuar në syllabuse posedojnë gradën e duhur akademike, duke përbushur kërkesat ligjore, por nuk janë të profilat të fushës së programit të studimit, dhe në disa raste vijnë nga fusha krejtësisht të ndryshme. Lektor i lëndës duhet të ketë formim akademik dhe njohuri të thella në fushën e lëndës, pasi ai mban përgjegjësi për përmbajtjen akademike dhe cilësinë e saj; në mungesë të kësaj, kjo përgjegjësi nuk mund të garantohet. Për këto arsye, GVJ i qëndron rekomandimit të dhënë. GVJ konkludon që **RVJ nuk ndryshon.**

5. Në lidhje me komentin e Standardit IV.1 / Kriteri 8;

Përgjigje nga GVJ: GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për të siguruar bashkëpunim efektiv me partnerët pritës dhe menaxhim të qëndrueshëm të praktikës profesionale. GVJ merr parasysh arsyet e institucionit dhe partnerëve për organizimin aktual, i cili e bën më të lehtë menaxhimin e praktikës, por thekson se qëllimi kryesor i praktikës duhet të mbetet përfitimi i studentit, i cili duhet të ketë mundësi reale për aftësim praktik përmes përfshirjes në procese pune me vijimësi. Rekomandimi i GVJ i lë hapësirë institucionit për të gjetur një balancë të qëndrueshme midis nevojave të partnerëve pritës dhe maksimizimit të përfitimit pedagogjik dhe profesional të studentëve. GVJ konkludon që **RVJ nuk ndryshon.**

6. Në lidhje me komentën e Standardit IV.3 / Kriteri 2, konkluzione;

Përgjigje nga GVJ: GVJ vlerëson përpjekjet e Universitetit për menaxhimin e fondit të bibliotekës dhe aktivitetet e ndërmarra për përditësimin e literaturës. Megjithatë, edhe pse në komentën e institucioni pretendohet se procesi i përditësimit të literaturës, duke përcaktuar qartë hapat që ndiqen, është pjesë e Rregullores së Bibliotekës, GVJ ka konstatuar se kjo rregullore trajton kryesisht shërbimet e ofruara, huazimin e koleksioneve dhe kushtet e huazimit, përdorimin e burimeve elektronike dhe kompjuterëve, si dhe rregullat e përgjithshme të bibliotekës, por nuk përfshin hapat e procesit të pasurimit dhe përditësimit të literaturës. GVJ iu rikthye edhe një herë evidencës së dorëzuar (Evidenca 4.35-Rregullorja e Bibliotekës) dhe i qëndron këtij konstatimi. Për këto arsye, GVJ i qëndron rekomandimit të lënë dhe vlerëson që institucioni po shqyrton mundësinë për hartimin e një udhëzuesi të detajuar për këtë proces. GVJ konkludon që **RVJ nuk ndryshon**.

7. Në lidhje me komentën e Standardit IV.5 / Kriteri 3, konkluzione;

Përgjigje nga GVJ: GVJ vlerëson informacionin e dhënë nga WBU se institucioni ka kryer auditim të jashtëm pas përfundimit të procesit të vlerësimit. Megjithatë, gjatë vlerësimit, institucioni nuk ka paraqitur asnjë evidencë të auditimit financiar për vitet e akreditimit dhe as në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm nuk është bërë asnjë qartësim nëse ky proces është kryer, është duke u kryer apo është planifikuar së afërmi. Ky informacion nuk i është komunikuar GVJ-së as gjatë vizitës në institucion. Në dokumentat shtesë që u dorëzuan pas vizitës, nuk ishte përfshirë asnjë raport auditimi financiar për vitet e akreditimit, dhe nuk u dha asnjë informacion shtesë ose sqarues, megjithëse një nga dokumentet që u kërkua nga GVJ ishte "Raporti i auditimit financiar për vitet e akreditimit". Për këtë arsye, vlerësimi i GVJ është bazuar në informacionin dhe evidencat e disponueshme në momentin e vlerësimit të programit të studimit, dhe GVJ i qëndron rekomandimit të dhënë, pasi ai pasqyron realitetin gjatë procesit të vlerësimit. GVJ konkludon që **RVJ nuk ndryshon**.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në bazë të dokumentacionit dhe RVB të dorëzuar nga IAL “Universiteti Western Balkan” (WBU), GVJ vlerëson se programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”, i cili afrohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike është në përputhje me misionin e WBU shprehur në statutin e institucionit dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ky program studimi synon formimin e studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit në përputhje me kërkesat e tregut të punës. GVJ vlerëson se programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” ruan dhe konsolidon vlerat akademike e kulturore kombëtare. Ai synon t’u japë studentëve një edukim cilësor dhe të qëndrueshëm në përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës informatike. <i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Western Balkans.</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans.</i> <i>Evidenca 1.4-Plani Strategjik i WBU 2023-2030.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionale të WBU në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Informatikes dhe Inteligjencës Artificiale. <i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Western Balkans.</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans.</i>

	<i>Evidenca 1.3-Rregullorja e Fakultetit te Ekonomise, Teknologjise dhe Inovacionit.</i> <i>Evidenca 1.4-Plani Strategjik i WBU 2023-2030..</i>																																									
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” është në harmoni me strategjinë e IAL WBU ku vendos si objektiv strategjik cilësinë dhe performancën akademike brenda institucionit. Përmbushja e misionit të WBU realizohet edhe duke siguruar shumëllojshmëri të ofertave të formimit në përputhje me nevojat e zhvillimit të sotëm dhe të ardhshëm të vendit. Statuti i “WBU” përcakton qartë drejtimet prioritare akademike, ato përputhen me fushat e studimit të programit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” të Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Infovacionit dhe Departamentit të Shkencave Kompjuterike, prej nga varet programi i cilkit tëparë i studimit bachelor. <i>Evidenca 1.1Statuti i Universitetit Western Balkans.</i> <i>Evidenca 1.4-Plani Strategjik i WBU 2023-2030.</i>																																									
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se WBU ka përvijë dhe eksperiencë në fushën akademike, kapacitetet në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse universitare. Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në realizimin e programit të studimit, në vitin akademik 2024-2025 përbëhet nga: 1 Prof. As., 5 Lektorë me gradën Doktor dhe 5 Asistent-Lektorë me gradën Msc., në total 11 PAE, ndërsa personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga: 1 Dr. 3 Msc, në total 4 PAK. Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit për tre vitet e fundit akademike ka në strukturën e tij këto të dhëna: <table><tr><th rowspan="2">Personeli i angazhuar në FETI</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>2</td></tr><tr><td>Prof.Assoc</td><td>3</td><td>1</td><td>4</td><td>4</td><td>3</td><td>3</td></tr><tr><td>Dr/Doc</td><td>6</td><td>4</td><td>10</td><td>3</td><td>17</td><td>5</td></tr><tr><td>Msc</td><td>14</td><td>3</td><td>11</td><td>6</td><td>9</td><td>6</td></tr></table>	Personeli i angazhuar në FETI	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof Dr	-	-	-	-	1	2	Prof.Assoc	3	1	4	4	3	3	Dr/Doc	6	4	10	3	17	5	Msc	14	3	11	6	9	6
Personeli i angazhuar në FETI	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																					
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																				
Prof Dr	-	-	-	-	1	2																																				
Prof.Assoc	3	1	4	4	3	3																																				
Dr/Doc	6	4	10	3	17	5																																				
Msc	14	3	11	6	9	6																																				

	Në total	23	8	25	13	30	16
	Përbërja e Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përgjegjës për këtë program studimi, paraqitet si në vijim:						
	Departamenti i Shkencave Kompjuterike,	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof Dr	-	-	-	-	1	-
	Prof.Assoc	1	1	1	2	-	-
	Dr/Doc	2	3	4	2	4	-
	Msc	5	3	4	1	5	3
	Në total	8	7	9	5	10	3
	<i>Evidenca 1.12-Lista e Laboratoreve te WBU.pdf</i> <i>Evidenca 1.11-Lista e personelit akademik qe angazhohet per realizimin e programit te studimit Bachelor ne Shk.pdf</i> <i>Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Shqip_CAI FINAL Final., Tabelat 6.</i> <i>4.RVB Bachelor Shkenca Kompjuterike dhe AI.</i>						
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Infovacionit, ofron programe studimi në fushën e informatikës që prej vitit 2021. Drejtimet kërkimore shkencore të Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Infovacionit janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, ka si fushë të përgjithshme fushën e informatikës dhe Inteligjencës Artificiale në përputhje me fushën akademike dhe shkencore të njësive kryesore, me kodifikim 63BA06 I 9A <i>Evidenca 1.3-Rregullorja e Fakultetit te Ekonomise, Teknologjise dhe Inovacionit.</i> <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 1.15-Klasifikimi dhe kodifikimi i Programit të studimit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike dhe Intelig.</i>						

Konkluzione	<i>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”, ofruar prej Departamentit të Shkencave Kompjuterike në Fakultetin e Ekonomisë, Teknologjisë dhe Infovacionit pranë “WBU” është në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike. Institucioni disponon infrastrukturën dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin me cilësi të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren tij dhe në rregulloren e njësive kryesore. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Shkencave Kompjuterike ofron programin e studimit Bachelor “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”. Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit si: Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe Protokolli, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, etj. dhe departamentet e tjera në Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Infovacionit të “Universitetit Western Ballkan”, gjë që çon në përmirësimin e efektivitetit të këtij programi studimi. <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans.</i> <i>Evidenca 6.4-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik.</i> <i>Evidenca 6.16-Raporti i vlerësimit të institucionit nga personeli për vitin akademik 2022-2023 2023-2024.</i>

	<i>Vizita në Institucion, takimi me përgjegjës të departamentit</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor të formës së studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Universiteti “Western Balkan” ka bashkëpunime ndër-institucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës. Realizimi i praktikave profesionale mbetet një ndër bashkëpunimet kryesore me këto institucione. Me anë të këtyre bashkëpunimeve WBU synon gjithashtu krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve, por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit. Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka nënshkruar mbi 16 marrëveshje specifike të vitit 2023-2024 për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” por një pjesë e vogël e tyre mbështesin këtë program. <i>Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU.</i> <i>Evidenca 3.39-Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Departamentit Shkenca Kompjuterike dhe Inte.</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	GVJ konstaton se procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet udhëzuesit për zhvillimin e praktikës. Në të janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen, ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces. Departamenti i Shkencave Kompjuterike duhet të përshtatë Manualin praktik dhe kurikulen e integruar EPIC për programin konkret të studimit “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”. Pasi ai është jashtë fushës së mbulimit të programit. <i>Evidenca 1.26-Manuali i praktik EPIC për programin e studimit Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artific.pdf</i> <i>Evidenca 1.27-Udhëzimi për Kurrikulën e Integruar të Edukimit me Praktikën (EPIC).</i> <i>Evidenca 1.14-Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU për Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artific</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve	Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përgjegjës për programin e studimit, nuk ka realizuar një raportim analitik të mirfillt për përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve, në “Evidenca 3.40-Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i

nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<i>Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacione pika 12 shprehet</i> Nuk është njësia kryesore përgjegjëse për Praktikat profesionale, por EPIC Team. Ne raportin e punës shkencore të departamentit ka një raportim për realizimin e praktikave mësimore/profesionale për të gjithë departamentin, përfshirë edhe programin e studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale". <i>Evidenca 3.40-Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacione</i> <i>Evidenca 1.22-Raporti i punës kërkimore-shkencore i Departamentit të Teknologjisë dhe Biznesit.</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me përgjegjësin e departamentit</i>			
Konkluzione	<i>Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe njësia kryesore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në "Universiteti Western Ballkan" ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë realizimin e objektivave të programit të studimit.</i> <i>Departamenti ka bashkëpunimeve me entet vendase për zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre në ciklin e parë.</i> <i>Departamenti duhet të shtojë numrin e bashkëpunimeve për këtë program pasi një pjesë e vogël e tyre mbështesin këtë program.</i> <i>Departamenti i Shkencave Kompjuterike duhet të pershtase Manualin praktik dhe kurikulen e integruar EPIC për programin konkret të studimit "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale", pasi ai është jashtë fushës së mbulimit të programit.</i> <i>Departamenti dhe njësia kryesore duhet të përfshijnë në menyre analitike përfitimeve nga marrëveshjet për praktiken profesionale</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” organizohet në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje normale 3 vite dhe në total 180 kredite. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, dhe VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021. Në planin mësimor sipas Veprimtarive Formuese lëndët janë paraqitur të ndara sipas tipit të veprimtarisë, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplimore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr. 879, datë 18.12.2019]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep	Programi i studimit, nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara, krijon mundësinë e formimit të shprehive të veçanta. Gjithashtu programi synon që studentët të jenë në gjendje të përcaktojnë zgjidhje të proceseve informatike fushën e TIK duke shfrytëzuar analiza dhe kriteret të aplikuara në këtë fushë

njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	për sisteme të tilla. GVJ konstaton se objektivat formuese përmbushen mirë. Studimi i tregut i kryer ka evidentuar disa specialitete për të cilat formohen studentët e këtij programi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se programi i studimit thellon njohuritë e studentëve në fushën e TIK, ku një vend të konsiderueshëm në program zë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve të programimit dhe AI. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 3.3-Sylabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike.</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i programit mësimor dhe syllabuseve rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh. GVJ konstaton se lëndët/modulet janë grupuar sipas veprimtarive formuese në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar. Programi ka të përcaktuara veprimtaritë formuese, kryesisht leksione dhe seminare. Gjatë vizitës GVJ konstatoi laboratorët mbështes për lëndët laboratorike ku mundësohet dhe praktikimi i njohurive në praktikë. GVJ konstaton se shpërndarja e tyre është në përputhje me aktet ligjore e nënëligjore në fuqi. - <i>Lëndë bazë:</i> Përgatitje metodologjike dhe kulture e përgjithshme (A): 6 lëndë gjithsej me 30 ECTS. 16% te totalit; - <i>Lëndë karakterizuese përgatitje për disiplinën shkencore (B):</i> 18 lëndë gjithsej me 97 ECTS. ose 53% te totalit; - <i>Lëndë ndërdisiplinore / integruese:</i> ndërdisiplina profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C): 5 lëndë gjithsej me 26 ECTS ose 14 % të totalit; - <i>Lëndë plotësuese:</i> gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale (D): 4 lëndë. gjithsej me 22 ECTS. ose 12% të totalit;

	- <i>Detyrime përmbledhëse (E). 1 lëndë gjithsej me 7 ECTS. ose 4 % të totalit;</i> <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 3.3-Sylabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.	GVJ konstaton se në kurrikulën dhe në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale" janë përcaktuar ngarkesa mesimore për praktikën profesionale prej 7 ETCS dhe teza e diplomës 7 ETCS. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N / A
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale" në Departamenti i Shkencave Kompjuterike bashkë me programet e studimit kanë një ngjashmëri me programin Bachelor "Artificial Intelligence and Data Science" në Canadian Institute of Technology (CIT) https://cit.edu.al/bachelor-artificial-intelligence-and-data-science-english

Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Institucioni është angazhuar në përgatitjen e kodifikimit dhe dorëzimin e programit të studimit dhe kodifikimi i lëndëve është 63BA0619A. <i>Evidenca 1.15-Klasifikimi dhe kodifikimi i Programit të studimit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike dhe Intelig.</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas apo të huaj.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale" ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve të aftë për tregun e punës.</i> <i>WBU ndjek politikën dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studentëve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</i> <i>Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Institucioni është angazhuar në përgatitjen e kodifikimit të brëndëshëm të lëndëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” është licencuar përmes Urdhërit të Ministrit Arsimit dhe Sportit Nr. 416. date 14.07.2022. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit ka në përbërjen e tij 4 njësi bazë:

1. Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë;
2. Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës;
3. Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
4. Qendra Kërkimore- Shkencore SMTI;

Stafi akademik i Departamenti i Shkencave Kompjuterike është një kombinim i pedagogëve me tituj dhe me ekperiencë si dhe me pedagogë të ftuar që zotërojnë një punë në ushtrimin e profesionit të tyre. Fakultetit i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI) për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024 ka në strukturën e tij këto të dhëna:

Personeli i angazhuar në FETI	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	-	-	-	-	1	2
Prof.Assoc	3	1	4	4	3	3
Dr/Doc	6	4	10	3	17	5
Msc	14	3	11	6	9	6
Në total	23	8	25	13	30	16

Të dhënat për Departamenti i Shkencave Kompjuterike për tre vite akademike janë:

Departamenti i Shkencave Kompjuterike,	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	-	-	-	-	1	-
Prof.Assoc	1	1	1	2	-	-
Dr/Doc	2	3	4	2	4	-
Msc	5	3	4	1	5	3
Në total	8	7	9	5	10	3




Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	GVJ vlerëson se praktikat mësimore zhvillohen në afate dhe me partnerët që WBU ka marrëveshje bashkëpunimi dhe nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga Departamenti. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjeve për praktikat mësimore institucioni pritës cakton një mbikëqyrës të praktikës. Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka përcaktuar një akademik (laborant), i cili mbikëqyr mbarëvajtjen e punës dhe mirmbajtjen e laboratorëve. Nga vizita në IAL dhe takimi me studentet praktika është e shtrire përgjatë simestrit në çdo javë të tijë në ditë të caktuara. GVJ rekomandon grupimin e ditëve të praktikës në një periudhë të vetme. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Përgjegjësia për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij është e përgjegjësit të departamentit. Koordinatorët e grupeve mësimore koordinojnë përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve të grupit mësimor, rishikimin etj., si dhe janë përgjegjës për ecurinë e praktikave profesionale. Koordinatori për studentët koordinon marrëdhëniet mes studentëve dhe stafit, kryen këshillimin e studentëve në lidhje me kurrikulën dhe raporton për problematika të studentëve në departament dhe tek përgjegjësi i departamentit. <i>Evidenca 2.7-Vendimi i FETIDSHK për koordinatorët e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Int.</i> <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë".</i> <i>Evidenca 1.3-Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit.</i>
Konkluzione	<i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për</i>

	<i>organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</i> <i>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, si pjesë e WBU zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe standardet e cilësisë në Arsimin e Lartë, të reflektuara edhe në aktet rregullatore të Institucionit.</i> <i>Në programin e studimit zhvillon mësim staf pedagogësh i kualifikuar të cilët kanë eksperiencë akademike dhe profesionale.</i> <i>GVJ rekomandon grupimin e ditëve të praktikës në një periudhë të vetme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbytjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Shkencave Kompjuterike disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbytjen e programit të studimit si: Rregulloren, programin mësimor, syllabuset, orarin, ngarkesën e stafit akademik, etj. Dosja e plotë e çdo viti mbahet në departamentin përkatës. <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 3.3-Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike"</i> <i>Evidenca 2.5-Ngarkesa e stafit akademik për programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteli."</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të	GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Në syllabuset e lëndëve jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminare, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj. Frekuentimi, ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset.

lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Ky program studimi ka një kohëzgjatje normale 3 vite dhe në total 180 kredite organizuar ne 6 semestra, me kohë të plotë. A. Lëndë Bazë: 30 ECTS / 16% (sipas VKM 15%-20%); B. Lëndë Karakterizuese: 95 ECTS / 53% (sipas VKM 50%-55%); C. Lëndë Ndërdisciplinore: 26 ECTS / 14% (sipas VKM 12%-15%); D. Lëndë Plotësuese (Praktika): 22 ECTS / 12,2% (sipas VKM 10%-15%); E. Detyrime Përmbyllëse: 7 ECTS / 4% (sipas VKM 3%- 5%). Vleresuar sipas dokumentit “Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”, ka mospërputhje me dokumentin “Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.pdf” dhe “4.RVB Bachelor Shkenca Kompjuterike dhe AI.pdf” ne numër kreditesh, si edhe ne emërtimin e lëndëve, renditjen dhe kodimin e brëndëshëm. <i>Vizita në Institucion, takimi me përgjegjësin e departamentit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit jepen në Rregulloren mësimore. Kandidatët fitues përzgjidhen nga Komisioni <i>Ad-Hoc</i>, i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekanati. Transferimi i studentëve në programe studimi të njëjta ose të afërta, vendase ose të huaja, dhe ekuivalentimi i studimeve rregullohen me procedurën e regjistrimit të studentëve. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e lëndëve janë të paraqitura në strukturë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi. Programet lëndore hartohen nga titullari i lëndës, sipas modelit të paraqitur në VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar. Në fillim të çdo semestri pedagogu i njeh studentët me programin lëndor dhe veprimtaritë e

praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	përfshira në të, me detyrimet dhe përgjegjësitë, me format e vlerësimit dhe provimin final. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 3.3-Syllabusët e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike"</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ konstaton se stafit akademik i kërkohet të përditësojë syllabusët në fillim të vitit akademik. Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.			
Konkluzione	<i>Departamenti i Shkencave Kompjuterike , si pjesë e WBU përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit.</i> <i>Instucioni kujdeset në përditësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve në përputhje me nevojat e tregut dhe ndryshimet më të fundit teknologjike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe	Emërtimi i programit të ciklit të parë Bachelor në "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale" është në përputhje me fushën akademike të tij. Përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. GVJ vlerëson se ky program studimi mundëson

aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike, një element mjaft i rëndësishëm ky për t'u përballur me tregun e punës pas diplomimit të tyre apo thellimit të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme në fushën e teknologjise së informacionit dhe inteligjencës artificiale. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 3.3-Sylabusët e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike"</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit në Bachelor "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale" dhe rezultateve të pritshme të nxënit, aftësimi profesional dhe kërkimit shkencor. Në vitin e I zhvillohen kryesisht lëndët bazë, ndërsa në vitin II dhe III zhvillohen lëndët karakterizuese, ndërdisiplinore dhe përmbyllëse. Kjo mundëson që baza teorike e lëndëve të formimit bazë të shërbejë në përvetësimin më të mirë të dijeve prej lëndëve me karakter profesional. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 3.3-Sylabusët e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike"</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit Bachelor "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale" dhe rrjedhimisht të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit. Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion/Ushtrime (seminar). Në secilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike. Gjate 3 viteve të studimit programi i studimit ka: • Leksione - 1140 orë,

	• Serninare(Ushtirime) · 270 orë, • Laboratore- 540 orë, • Detyra kursi - 0 orë • Praktike mesimore - 60 orë • Përgatitje per provimin e formimit /Temë diplome- 160 orë. Gjithsej 1950 orë në auditor përgjatë tre viteve dhe 2550 orë punë individuale jashtë auditorit me nje raport ore auditor 43% : orë jashtë auditori 57% <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën TIK dhe të AI. Njohuritë e marra gjatë studimeve në këtë program studimi i mundësojnë studentit transferimin ose/dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të parë/dytë në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, si dhe punësimin e tij në përputhje me fushën e studimit në ente publike dhe private kombëtare dhe ndërkombëtare. Sasia e orëve në auditor (1950 orë) për përgatitjen praktike (Seminare, laboratorë, projekte praktikë, etj) është 810 orë, nga 1140 orë totale për përgatitjen teorike (orët e leksioneve), ose orët në auditor për përgatitjen praktike zënë 41,5% të orëve totale në auditor. GVJ gjykon që raporti i tyre është në përputhje me ciklin e parë të studimeve. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme pasqyron në ciklet e leksioneve dhe seancave praktike të reja që lidhen me lëndët përkatëse. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi se në përgjithësi në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. <i>Evidenca 3.3-Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike</i> <i>Evidenca 4.36-Praktika e kërkesës për pasurimin e fondit të bibliotekës.</i>

Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Bazuar në lëndët e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përkatëse, evidentohet se programi i studimit ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli Bachelor. <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 3.3-Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike"</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale" u jep mundësi studentëve të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit, duke kombinuar teorinë me praktikën, siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e Shkencave të Informatike dhe të Inteligjences Artificiale. <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 3.3-Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike"</i> <i>Evidenca 2.8-Formulari i vlerësimit të programit nga studentët që diplomohen. Paketa e Instrumentave të Sigurise.</i>			
Konkluzione	Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në Programin e studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale", krijon mundësinë e formimit profesional të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi në përgjithësi në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmirësimit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ vlerëson se Departamenti i Shkencave Kompjuterike vlerëson periodikisht zhvillimet e detajuara të tregut për të përmirësuar kurrikulën e programit të studimit të ofruar në përputhje me mundësitë e punësimit të ofruara në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Ky program studimi nuk ka ende një brez të diplomuarish. <i>Evidenca 1.8 Analiza e tregut të punës Shkenca Kompjuterike dhe inteligjence artificiale.</i> <i>Evidenca 2.8-Formulari i vlerësimit të programit nga studentët që diplomohen. Paketa e Instrumentave të Si.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	GVJ vlerëson se nga Institucioni bëhen përpjekje për të mbështetur studentët për tu përfshirë në strukturat vendimmarrëse të tij. Ai nxit që në mbledhjet e Departamentit, Senatit Akademik përfaqësuesi i studentëve nga Këshilli Studentor dhe çdo student apo i diplomuar që të marrë pjesë në diskutimet dhe konsultimet për përmirësimin e programit të studimit. <i>Evidenca 2.10-Pjesëmarrja e studentëve në Senatin akademik.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	GVJ vlerëson se nga IAL mbahen kontakte të vazhdueshme me aktorë të tregut të punës për të përmirësuar kurrikulën e programit të studimit. Ky program studimi është i ri dhe nuk i është nënshtruar ndryshimeve dhe riorganizimit të mëtejshëm.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Konkluzione	<i>Institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale, vizita studimore. Syllabusët e lëndëve miratohen në departament. Gjithashtu personeli akademik fton eksperte ose lektore të ftuar për të organizuar ore mësimore të hapura në kuadër të shumëllojshmërisë së mësimdhënies. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans.</i> <i>Evidenca 3.1-Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe	Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” merr pjesë në trajnimet e orientuara në aspektet didaktike të

nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	mësimdhënies të organizuara nga WBU. Gjithashtu gjatë punës me studentët ata nxiten të përdorin metoda inovative të mësimdhënies. Personeli akademik merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans.</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	GVJ konstaton se “Universiteti Western Ballkan” ofron kushte dhe infrastrukturë të mirë për procesin e mësimdhënies, mbështet dhe stimulon personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike si dhe përditësimet e metodave të mësimdhënies, në përputhje edhe me objektivat dhe misionin e institucionit. Në funksion të programit të studimit janë laboratorët e Departamentit të Shkencave Kompjuterike, broshurat informuese, guida për studentët. GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe të ndryshme pedagogjike. <i>Evidenca 3.1-Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien.</i> <i>Evidenca 3.6-Plani i trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ për vitin akademik 2023-2024 2024.</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe	GVJ pas analizimit të CV-ve të personelit akademik konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” zotëron përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Nga anketimi i studentëve lidhur me procesin mësimor gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2022-2023 SEM I, 26 pyetësorë janë plotësuar nga studentët e programit Shkenca kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale prej 242 pyetësorë për Fakultetin i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit.

autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga rezultatet e pyetjes që vlerëson infrastrukturën evidentohet se institucioni ofron mjedise dhe infrastrukturë nxitëse për zhvillimin e programeve të studimit. Vlerësimi për stafin administrativ është pozitiv çka tregon një komunikim dhe bashkëpunim korrekt midis stafit dhe studentëve. <i>Evidenca 3.9- Personeli akademik i diplomuar jashtë vendit.</i> <i>Evidenca 3.13-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik 2023-2024.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	GVJ konstaton se format e metodat e mësimdhënies vlerësohen nga eprori dhe studentët, kjo nëpërmjet komunikimit direkt me pedagogun apo përgjegjësin e njësisë bazë, mendime që shprehen nga përfaqësuesi i studentëve në mbledhje të njësisë bazë etj. Pyetësorët e hartuar në mënyrë periodike janë një mënyrë tjetër vlerësimi për metodat e mësimdhënies. <i>Evidenca 3.13-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik 2023-2024.</i> <i>Evidenca 6.1-Pyetësor për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrativ. Paketa e instrume.</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin e NJSBC</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të	WBU ka ngritur “Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit” i cili bashkëpunon me NJBSC për të përgatitur raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuara. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Gjithashtu, WBU nxit shembuj të praktikave më të mira, inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimit, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar. Departamenti i Shkencave Kompjuterike është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare që WBU ka me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit si Erasmus+, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse. Universiteti Western Balkans ka MoU me Institucionin të Arsimit për vitin akademik 2022 – 2023 të neshkruara 16 marveshje bashkëpunimi.

mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<i>Evidenca 3.14-Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë.</i> <i>Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU.</i> <i>Evidenca 1.16. Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2023-2024 dhe planifikimi i ri vjetor.</i> <i>Evidenca 3.6-Plani i trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ për vitin akademik 2023-2024 2024.</i> <i>Evidenca 3.13-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik 2023-2024.</i>			
Konkluzione	<i>WBU kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm si: • Provimi përfundimtar (45%); • Kuize 5(%) • Provimi i ndërmjetëm (30%); • Projekti (20%). <i>Evidenca 2.2-Syllabus i lëndës "Hyrje në Shkencën e të Dhënave" Evidenca 3.23-Model Procesverbal vlerësimi i një lënde të caktuar</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive,	Nga takimi me studentët, GVJ konstaton se personeli akademik, në fillim të çdo lënde informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore dhe atë të programit. Rregullat e provimeve, pikët për testimet gjatë vitit, për detyrat,

dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	projektet, aktivizimi në seminare dhe formate të tjera vlerësimi janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve, që njihen nga studentët. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë".</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: • Provimi i ndërmjetëm; • Detyra e kursit (projekte), Kuize; • Provimi përfundimtar; Para provimit pedagogu informon studentët nëse kanë të drejtë të futen në provim, sa pikë kanë fituar gjatë kontrolleve gjatë vitit dhe me cilat kriteret do të vlerësohen përfundimisht. Sistemi i SMART-WBU dhe Google Classroom mundëson këtë informacion për studentët. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë".</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ konstaton se format e metodat e mësimdhënies vlerësohen nga eprori dhe studentët, kjo nëpërmjet komunikimit direkt me pedagogun apo përgjegjësin e njësisë bazë, mendime që shprehen nga përfaqësuesi i studentëve në mbledhje të njësisë bazë etj. Pyetësorët e hartuar në mënyrë periodike janë një mënyrë tjetër vlerësimi për metodat e mësimdhënies. <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit dhe stafin e departamentit</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe	Personeli akademik është inkurajuar nga "Universiteti Western Ballkan" të zbatojë mësimdhënien me në qendër studentin, e cila krijon mundësi që studentët të ndërtojnë vetë dijet duke ndërvepruar dhe punuar në mënyrë të pavarur, ndërsa

fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	pedagogët e programit të shndërrohen në mbështetës të procesit mësimor. <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit dhe stafin e departamentit</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ ka shqyrtuar rregulloren e programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” dhe ka konstatuar se në rregulloren e tij është përcaktuar se si realizohet testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Evidentohet fakti që raportet ndërmjet testimit e vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar përcaktohen nga pedagogët në programin e lëndës dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit. Format kryesore të kontrollit të vazhduar janë detyrat/projektet e kursit, provimet ndërmjetese, aktivizimi në seminare dhe punë laboratorike të cilat shërbejnë, ashtu si dhe provimi, për vlerësimin përfundimtar me notë.

	<i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë"</i> <i>Evidenca 3.3-Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike."</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimi dhe vlerësimi në "Universiteti Western Ballkan" është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale me mjetet elektronike. Kontrolli i dijes bëhet me forma të ndryshme si me gojë, me shkrim, me detyra kursi, me projekte. Në platformën LMS SMART-UWB personeli akademik i këtij programi studimi përdor forma të ndryshme kontrolli. <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë"</i> <i>Evidenca 3.24 Udhezimi për procesin e sekretimit të provimeve.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ vlerëson se vlerësimi në provimin përfundimtar është 45 pikë sipas përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve. <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë"</i> <i>Evidenca 3.23-Model Procesverbal vlerësimi i një lënde të caktuar</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i komponentëve të vlerësimit shoqërohet me komente nga pedagogu. Në të qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilësinë e punimeve të tyre. Edhe në takimin me studentët u konfirmua se procedura e kontrollit të dijeve dhe dhënia e rezultateve bëhet kryesisht sipas rregullores së Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe nga ana e studentëve nuk u evidentuan problematika që mund ta dëmtonin procesin. <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë"</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën,	Studentët që në fillim të procesit mësimor informohen për veprime të ndaluara si kopjimi e plagjiatura. Studenti i cili kryen veprime të ndaluara, përjashtohet nga provimi. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e

kopjimin në provime dhe detyra.	dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit. <i>Evidenca 3.25-Projekti për Sigurimin e Cilësisë QA-SURE.</i> <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë"</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve përgjithësisht brenda afatit të përcaktuar në rregullore 5 dite nga data e zhvillimit të tyre, në raste të vecata për shkak të ngarkesës së pedagogut mund të kalohet ky afat. Studentet e vlerësojnë rregullin e dhënies së rezultateve. Rezultatet e kontrollit të dijeve merren pasi korrigjohen provimet me shkrim dhe merret parasysh edhe ecuria e studentit gjatë semestrit, sipas pikëve të përcaktuar në sylabuset (frekuentimi, pjesëmarrja në diskutime, performanca në kryerjen e detyrave etj.) <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Çdo student ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë në provim brenda 7 diteve pas kryerjes së provimit. Komisioni i vlerësimit sqaron vlerësimin e bërë dhe në rast mosdakordësie studentit i lind e drejta e ankimit duke e depozituar me shkrim pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës, brenda 15 ditëve nga shpallja e rezultateve. <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans.</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	GVJ konstaton se në rregullore përcaktohet se ankimimi i studentit ngrihet një komision me tre anëtare ad-hoc. Rivlerësimi i provimit merret brenda dy jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans.</i>
Konkluzione	<i>Departamenti i Shkencave Kompjuterike në rregulloren e programit të studimit përcakton procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimit.</i>

	<i>Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Mbështetur në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”, GVJ konstaton se synohet formimi i ekspertëve dhe specialistëve në nivel cilësor në fushën e inxhinierisë informatike dhe Inteligjences Artificilae. Veprimtaritë formuese zhvillohen dhe grupohen në 5 kategori: - 6 lëndë bazë 16%; - 18 lëndë karakterizuese 53%; - 5 lëndë ndërdisiplinore 14%; - 4 lëndë plotësuese 12,2%; - 1 lëndë përmbyllëse 4%; Pra, zhvillimi i programit të studimit bëhet sipas VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar dhe mundëson marrjen e njohurive në mënyrë të balancuar dhe që lejon aftësimin profesional të studentit. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit Bachelor “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” zhvillon aftësi të veçanta në fushën e inxhinierisë informatike përmes lëndëve karakterizuese sipas drejtimeve që ka programi i studimit. Në programin lëndor ka lëndën "Gjuhë e huaj", në të thellojnë njohuritë e tyre në gjuhën angleze dhe terminologjinë teknike. Programi i studimit siguron zhvillimin e aftësive të avancuara në fushat e teknologjisë së informacionit, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, sepse në kurrikulën e tij janë përfshirë lëndë bazë dhe të avancuara te teknologjisë informacionit. Syllabuset

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	e programit të studimit garantojnë përveç zhvillimit të aftësive e kompetencave në fushën kompjuterike, edhe aftësimin në fushat e menaxhimit, ekonomike, të komunikimit dhe gjuhës së huaj. <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të vitit akademik pedagogët titullarë të lëndëve analizojnë kompetencat dhe aftësitë e përfituara nga studenti. Stafi akademik harton raportin semestral, në të cilin raporton për realizimin e objektivave të mësimdhënies. Departamenti i Shkencave Kompjuterike analizon kompetencat profesionale të fituara nga studentët dhe i paraqet ato në analizën vjetore të tij në programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”. <i>Evidenca 3.39-Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Departamentit Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencës.</i> <i>Evidenca 3.40-Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me	GVJ vlerëson se personeli akademik transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer ekspertiza laboratorike. Gjate zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme në fushën e inxhinierisë informatike dhe inteligjencës artificiale. Sipas RVB dhe në bazë të vizitës së GVJ në institucion, personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Stafi akademik i Departamenti i Shkencave Kompjuterike mbështet implementimin e ideve inovative të studentëve, gjatë detyrave të kursit, diplomave, si dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në konferencën studentore. <i>Evidenca 3.31. Trajnimi i zhvilluar për studentët rreth kërkimit shkencor.</i> <i>Evidenca 3.29-Lista e studentëve përfitues të programit EPIC 2022-2023 dhe 2023-2024</i>

Alban

4

institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.				
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” është angazhuar edhe në veprimtari të tjera si konferenca apo seminare të ndryshme, ku kanë prezantuar edhe teknologji të ndryshme në auditore të zgjeruara si leksione të hapura. <i>Vizita në Institucion, takimi me personelin akademik të programit</i>			
Konkluzione	Në WBU funksionon Zyra e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, e cila në bashkëveprim me Përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Kompjuterike promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. <i>Departamenti i Shkencave Kompjuterike monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për	“Universiteti Western Ballkan” ka hartuar një rregullore diplomimi, e cila jep në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet për temën e diplomës. Studentët me mesatare mbi 7 mund të përzgjedhin zhvillimin e temës së diplomës. <i>Evidenca 3.35-Manuali për punimin e diplomës</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans.</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale.</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

punim diplome dhe e bën atë publike.	
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti i Shkencave Kompjuterike angazhon stafin akademik të orientojnë studentët në procesin e përmbylljes së studimeve. Kjo bëhet duke dhënë informacion në lidhje me mënyrën e përzgjedhjes së temës, si dhe japin udhëzime dhe literaturë shtesë (në rastin e temës së diplomës). <i>Evidenca 3.35-Manuali për punimin e diplomës</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i formimit nuk aplikohet në këtë program studimi. Studenët që ndjekin programin e studimit Bachelor “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” përmbyllin studimet me temë diplome nëse kanë mesataren mbi 7. <i>4.RVB Bachelor Shkenca Kompjuterike dhe AI.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Nga vizita në WBU në takimin me studentët dhe me stafin akademik të këtij programi studimi, të dy palët konfirmuan se studentët ndihmohen përmes orientimeve të vazhdueshme, informacioneve e literaturës në procesin e përmbylljes së studimeve. Rregullorja mësimore përcakton se është udhëheqësi i diplomës që drejton, këshillon e konsulton. <i>Evidenca 3.35-Manuali për punimin e diplomës</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të	Institucioni vë në dispozicion ambientet e tij (laboratorët) ose lehtëson aksesin në ambientet e institucioneve bashkëpunuese në mbështetje të realizimit praktik të punimit të diplomës. <i>Evidenca 4.25-Lista e laboratorëve të WBU për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

temave dhe fushës së studimit.				
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Udhëheqësi i punimit vlerëson punimin e studentit mbështetur në kriteret aprovuara në rregulloren themelore. Komisioni i diplomës vlerëson përfundimisht punimin e diplomës me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Vlerësimet me notë janë nga 1 në 10, ku nota më e ulët për kalim është 5 si edhe vlerësimin me germa.			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në procedurën e diplomimit studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj të miratuar nga Senati Akademik i "Universiteti Western Ballkan", në përputhje me udhëzimet e Ministrisë. Në përfundim të studimeve, institucioni vendos në dispozicion të studentëve një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, sipas vitit akademik përkatës, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. <i>Evidenca 5.2-Model Diplome.</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sipas RVB, WBU mban një kopje të dokumentacionit të studentit për një periudhë të pacaktuar me qëllim pajisjen e studentëve me informacione nëse kërkohen. <i>Evidenca 3.38-Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore.</i> <i>Vizita në Institucion, takimi në sekretarinë mësimore</i>			
Konkluzione	<i>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale" përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit.</i> <i>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Për shqyrtimin e këtij kriteri, GVJ analizoi me kujdes të gjitha evidencat e paraqitura dhe konstatoi se ka mospërputhje mes tyre. Konkretisht, personeli akademik i specifikuar në disa prej syllabuseve të lëndëve si lektorë dhe asistent-lektorë nuk përputhet me personelin e përcaktuar në tabelat 4 dhe/ose tabelat 12 të tabelave përmbledhëse. Mospërputhje vërehen edhe midis tabelave 4 dhe tabelave 12, të të njëjtit vit akademik, brenda të njëjtit dokument. Të dhënat mbi angazhimin e lektorëve dhe asistent-lektorëve në lëndët e programit të studimit dhe ngarkesës totale vjetore të tyre u krahasuan edhe me të dhënat e paraqitura në raportet vjetore të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore për vitet akademike përkatëse. GVJ konstatoi sërish mospërputhje në të dhëna midis këtyre raporteve dhe të dhënave në tabelat përmbledhëse dhe në disa raste edhe mes raporteve të njësisë bazë dhe asaj kryesore për të njëjtin vit akademik. Nga shqyrtimi i CV-ve të dorëzuara, rezulton se për një pjesë të lektorëve të përcaktuar në syllabuset e lëndëve, nuk janë vënë në dispozicion CV-të përkatëse. Megjithë atë, për të bërë një analizë të plotë, GVJ shqyrtoi biografinë e tyre të publikuar në faqen zyrtare të internetit të WBU. <i>Nga analiza e CV-ve dhe biografisë së publikuar në web, rezulton se për një pjesë të lëndëve, profili akademik i lektorëve të përcaktuar në syllabuse <u>nuk përputhet me fushën e lëndës që mbulojnë</u>, ndonëse asistent lektorët janë të profilit përkatës.</i> Nga shqyrtimi i të dhënave të paraqitura (Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB), të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin e studimit Bachelor në "Shkenca

Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë:

Titulli	Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”					
	2022 – 2023		2023 – 2024		2024 – 2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	0	0	0	0	0	0
Prof.As.	1	1	1	1	1	0
Dr./PhD.	3	3	5	1	5	1
MSc.	6	4	5	1	5	3
Totali	10	8	11	3	11	4

Për sa konstatuar më sipër, GVJ rekomandon që:

- Institucioni të përcaktojë dhe zbatojë një metodologji të unifikuar për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave mbi ngarkesën mësimore dhe angazhimin e stafit, duke siguruar përputhshmëri të plotë mes raportimeve të brendshme periodike, raportimeve zyrtare dhe dokumentacionit të programit të studimit;
- Lektorët e lëndëve të jenë të fushës përkatëse të lëndës, në përputhje me kërkesat akademike dhe natyrën e programit të studimit;
- Lektorët dhe/ose asistent-lektorët e përcaktuar në syllabus të angazhohen në zhvillimin e procesit mësimor, duke shmangur devijimet ndërmjet planifikimit dhe praktikës së përditshme;
- Dokumentacioni i programit të studimit të përmbajë të gjitha CV-të e personelit të angazhuar në programin e studimit;

Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB;

CV_FINAL CAI;

Evidenca 3.3-Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit “Bachelor në Shkenca Kompjuterike;

Evidenca 2.3-Syllabus i lëndës “Projekt PërfundimtarPraktikë Profesionale”;

Evidenca 2.2-Syllabus i lëndës “Hyrje në Shkencën e të Dhënave”;

	<i>Silabuse CAI.pdf;</i> <i>Evidenca 4.4-Ngarkesa totale e personelit akademik të programit të studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike;</i> <i>Evidenca 3.40-Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inova;</i> <i>Evidenca 1.22-Raporti i punës kërkimore-shkencore i Departamentit të Teknologjisë dhe Biznesit (Departament</i> <i>Evidenca 1.23-Raporti i punës kërkimore-shkencore i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Biznesit (FET;</i> <i>Evidenca 1.9 Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale</i>								
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Për vlerësimin e këtij kriteri GVJ iu referuar të dhënave mbi ngarkesën mësimore të personelit efektiv dhe me kontratë të angazhuar në programin e studimit të paraqitura në Tabelat 12.1, 12.2 dhe 12.3 të Tabelave përmbledhëse si dhe Udhëzimit për ngarkesën mësimore të WBU. Referuar këtyre të dhënave, GVJ konstaton se në vitin akademik 2022 – 2023 raporti i përfshirjes së personelit akademik efektiv në mbulimin e ngarkesës mësimore për këtë program studimi nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. Megjithatë, institucioni ka ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e kësaj situate, duke reflektuar një angazhim të qartë në plotësimin e këtij standardi. Si rezultat, gjatë dy viteve akademike pasuese, 2023 – 2024 dhe 2024 – 2025, ky tregues është përmirësuar ndjeshëm dhe është përmbushur plotësisht, me mbi 70% të ngarkesës mësimore të mbuluar nga personeli akademik efektiv, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Shpërndarja e ngarkesës për tre vitet akademike për këtë program studimi është sipas tabelës më poshtë: <table><tr><th>Statusi</th><th>2022-2023</th><th>2023-2024</th><th>2024-2025</th></tr><tr><td>PAE/PAK</td><td>54% / 46%</td><td>86% / 14%</td><td>87% / 13%</td></tr></table> Përsa i takon ngarkesës totale vjetore të personelit akademik efektiv dhe me kontratë GVJ iu referua të dhënave të paraqitura në Tabelat 4.1, 4.2 dhe 4.3, raporteve vjetore të njësisë bazë si dhe shqyrtoi raportet vjetore të njësisë kryesore. Siç u evidentua edhe në kriterin e mësipërm, GVJ konstaton se ka mospërputhje në të dhënat e paraqitura mes raporteve dhe tabelave përmbledhëse për të njëjtin vit akademik. Megjithë atë, bazuar në evidencat e paraqitura, pavarësisht mospërputhjeve të evidentuara, GVJ vëren se ngarkesa totale vjetore, mbetet	Statusi	2022-2023	2023-2024	2024-2025	PAE/PAK	54% / 46%	86% / 14%	87% / 13%
Statusi	2022-2023	2023-2024	2024-2025						
PAE/PAK	54% / 46%	86% / 14%	87% / 13%						

	brenda kufijve të përcaktuar nga udhëzimi përkatës, ndërsa përsa i përket numrit të lëndëve për semestër, institucioni vepron në përputhje me udhëzimin me përjashtim të një rasti me 7 lëndë në total në vit (2023 – 2024). Përsa konstatuar më sipër, GVJ rekomandon që institucioni të operojë në përputhje me udhëzimin e vetë institucionit për numrin maksimal të lëndëve në semestër. <i>Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB;</i> <i>Evidenca 4.5-Udhëzimi për ngarkesën mësimore në Universitetin Western Balkans</i> <i>Evidenca 1.22-Raporti i punës kërkimore-shkencore i Departamentit të Teknologjisë dhe Biznesit (Departament</i> <i>Evidenca 1.23-Raporti i punës kërkimore-shkencore i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Biznesit (FET.</i> <i>Evidenca 3.40-Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inova</i> <i>Evidenca 3.39-Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Departamentit Shkenca Kompjuterike dhe Inte</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Referuar evidencave të paraqitura, vërehet se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është përgjithësisht i qëndrueshëm. Kjo gjë u konstatua edhe gjatë vizitave në institucion, ku GVJ u njoh me disa kontrata pune të personelit efektiv dhe personelit me kontratë. Po ashtu, referuar evidencave ku paraqitet personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi vërehet se përgjithësisht i njëjti personel akademik është angazhuar gjatë tre viteve të periudhës së akreditimit. GVJ konstaton se WBU i kushton rëndësi qëndrueshmërisë së personelit akademik duke qenë proaktiv dhe ofrimin e mundësive të vazhdueshme për avancimin e tyre profesional. Po ashtu, GVJ e konsideron si një praktikë të mirë mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit përmes marrëveshjes së bashkëpunimit me spitalin Amerikan që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë e personelit. Referuar evidencave dhe kontratave individuale të punës të vëna në dispozicion gjatë vizitës në instituion, GVJ konstaton se janë në përputhje me ligjin Nr. 80/2015, Neni 59. <i>Evidenca 4.4-Ngarkesa totale e personelit akademik të programit të studimit “Bachelor në Shkenca Kompjuterike;</i>

	<i>Evidencës 4.10- Model kontrate të punës së personelit akademik;</i> <i>Evidencës 4.14- Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se rekrutimi i personelit akademik bëhet përmes një procesi përzgjedhjeje transparent dhe të mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e saj. Këto kritere miratohen nga rektorati. Vendet vakante shpallen në faqen zyrtare të internetit të WBU. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga një komision ad-hoc. Gjatë vizitës në institucion GVJ u vu në dijeni se gjatë procesit të rekrutimit, pas përfundimit me sukses të intervistimit, kandidatëve mund t'i kërkohej të zhvillojnë një leksion të hapur në prani të personelit akademik. Punësimi i kandidatit miratohet nga Bordi i Administrimit dhe personeli pajiset me kontratë individuale të punës Rekrutimi i personelit akademik me kohë të pjesshme ndjek të njëjtat hapa. Në përfundim të procesit, lidhet kontratë shërbimi. <i>Evidenca 4.16-Praktika e punësimit në WBU;</i> <i>Evidenca 4.14- Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;</i> <i>Evidenca 4.15-Linku në website për publikimin e vendeve të lira të punës;</i> <i>Evidenca 4.16-Praktika e punësimit në WBU;</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Referuar Rregullores mbi organizimin akademik, WBU angazhon personel ndihmës akademik me karakter mësimor për realizimin e veprimtarive mësimore. Sipas nenit 29 të rregullores, në këtë kategori përfshihen asistentët mësimor dhe kërkimor, laborantët, teknikët, etj. Gjatë vizitës në institucion GVJ u vu në dijeni se personeli i njesisë TIK në WBU është gjithashtu i angazhuar në mirëmbajtjen e pajisjeve laboratorike në shërbim të programit të studimit Bachelor në "ShKIA". <i>Evidenca 1.17-Rregullorja mbi organizimin akademik të Universitetit Western Balkans;</i>

Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Referuar <i>nenit 32</i> të rregullores mbi organizimin administrativ të WBU dhe takimit në institucion, GVJ konstatoi se zyra e burimeve njerëzore në WBU mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Kjo zyrë ndjek procesin e rekrutimit të personelit, caktimit dhe ndryshimeve në detyrë, ruajtjen dhe përditësimin e dosjeve të personelit. Gjatë vizitës GVJ shqyrtoi dosje të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Në dosjen e personelit akademik efektiv dhe kohë të pjesshme u gjendën këto dokumente: • CV-ja • Diploma e arsimit të lartë të kryer, lista e notave si dhe dokumenta të tjera kualifikimi, përfshirë gradat akademike të noterizuara. • Leje angazhimi • Dëshmi penaliteti • Libreza shëndetësore • Raporti mjeko ligjor • Numri i llogarisë bankare • Dokument identifikimit • 2 fotografi • Certifikata e gjuhës angleze e noterizuar • Libreza e punës • Vërtetim page <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe diskutimeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se WBU ka nënshkruar dhe ka efektive marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit dhe biznese të ndryshme që operojnë në fushën e programit të studimit, përmes të cilave realizon praktikat profesionale. Studentëve që kryejnë praktikën profesionale iu caktohet një pedagog udhëheqës që ndjek ecurinë e tyre gjatë praktikës dhe mban kontaktet me institucionin pritës. Referuar statutit dhe rregullores themelore të WBU temat e projekt-diplomave si dhe anëtarët dhe kryetarët e komisioneve të mbrojtjes së diplomave propozohen nga njësia bazës dhe miratohet nga dekanati. <i>Evidenca 3.30-Marrëveshjet e bashkëpunimit të WBU për programin e studimit;</i>

natyrës së programit të studimit.	<i>Evidenca 1.1 -Statuti i Universitetit Western Balkans; Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktika profesionale për programin e studimit Bachelor në “ShKIA” zhvillohet gjatë semestrit të parë të vitit të tretë dhe është 7 ECTS, 175 orë pune, nga të cilat 15 orë zhvillohen në auditor, 60 orë në institucion dhe 100 orë punë individuale. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se praktikat profesionale vlerësohen nga një komision që ngrihet nga departamenti për mbrojtjen e praktikës nga studentët. Në përfundim të praktikës studentët përgatisin një raport, e prezantojnë atë para komisionit dhe vlerësohen me notë, ndërkohë që gjatë zhvillimit të praktikës raportojnë çdo javë për ecurinë. Gjatë vizitës, si dhe referuar përmbledhjes mbi procedurën e praktikës, GVJ u informua se praktika në institucion kryhet 1 ditë në javë (dita e hënë është lënë ditë e lirë nga angazhimet mësimore për këtë qëllim) gjatë gjithë semestrit, megjithatë atë referuar formularit të kryerjes së praktikës, rezultoi se studentët e kanë kryer praktikën në periudha të ndryshme kohore, që shtrihen nga një semester i plotë në dy javë. Periudha e praktikës do të duhej të ishte minimalisht e shtrirë në 8 javë (duke supozuar 8 orë punë në një ditë të hënë), gjë që tregon se jo gjithmonë është zbatuar ky rregull. Institucioni nuk ka paraqitur një rregullore që qartëson formalisht procedurën e praktikës profesionale. GVJ vëren se organizimi i praktikës profesionale vetëm një ditë në javë përgjatë gjithë semestrit, nuk përbën një praktikë të mirë për realizimin efektiv të objektivave të praktikës profesionale. Një organizim i tillë nuk i mundëson studentit të integrohet realisht në përditshmërinë e punës në institucion, të jetë pjesë e proceseve të vazhdueshme të institucionit dhe të ndjekë ciklin e plotë të detyrave të përditshme. Praktika profesionale duhet të shërbejë jo vetëm për të aplikuar njohuritë e marra në programin e studimit, por edhe për të kuptuar dinamikën dhe kërkesat e një mjedisi pune, të marrë pjesë në detyra që mund të kenë afate dhe vijimësi përtej një dite pune, si dhe të përshtatet me ritmin dhe kërkesat e institucionit pritës. Në këtë kontekst, GVJ rekomandon që praktika profesionale të organizohet në një periudhë të pandërprerë ose me disa ditë konsektive në javë, në mënyrë që të mundësohet vazhdimësia e proceseve të punës së studentit gjatë praktikës, pa cënuar zhvillimin e procesit mësimor. Po ashtu, rekomandohet që procedura e praktikës profesionale të formalizohet me një rregullore të posaçme.

	<i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale;</i> <i>Evidenca 3.28 Formulari i kryerjes së praktikës;</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në programin "ShKIA" përmbush kriteret ligjore dhe mbulon ngarkesën mësimore sipas kërkesave të programit. Personeli që realizon mësimdhënien është i profilit të lëndëve që mbulon, ndërsa në disa raste titullarët e lëndëve nuk janë të fushës përkatëse. Institucioni zbaton procedura të hapura dhe transparente për rekrutimin e stafit dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë dhe biznese, duke mundësuar, ndër të tjera, edhe zhvillimin e praktikave profesionale për studentët.</i> <i>GVJ vlerëson që WBU është proaktive dhe ka në fokus qendrueshmërinë e stafit, jo vetëm përmes trajnimeve, por edhe përmes incentivave si marrëveshja me Spitalin Amerikan për sigurimin shëndetësor të punonjësve.</i> <i>Sa i përket praktikës profesionale, GVJ vëren se organizimi një ditë në javë nuk i mundëson studentit përfshirje të plotë në përditshmërinë e institucionit dhe angazhim në detyra me vijimësi. Gjithashtu, evidencat mbi procedurat e praktikës mbeten të pamjaftueshme.</i> <i>GVJ rekomandon që:</i> <i>• Institucioni të përcaktojë dhe zbatojë një metodologji të unifikuar për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave mbi ngarkesën mësimore dhe angazhimin e stafit, duke siguruar përputhshmëri të plotë mes raportimeve të brendshme periodike, raportimeve zyrtare dhe dokumentacionit të programit të studimit.</i> <i>• Lektorët e lëndëve të jenë të fushës përkatëse të lëndës, në përputhje me kërkesat akademike dhe natyrën e programit të studimit.</i> <i>• Lektorët dhe/ose asistent-lektorët e përcaktuar në syllabus të angazhohen në zhvillimin e procesit mësimor, duke shmangur devijimet ndërmjet planifikimit dhe praktikës së përditshme.</i> <i>• Dokumentacioni i programit të studimit të përmbajë të gjitha CV-të e personelit të angazhuar në programin e studimit.</i> <i>• Praktika profesionale të organizohet në mënyrë të pandërprerë ose me disa ditë konsektive në javë, si dhe</i>

	<i>të formalizohet procedura e zhvillimit të praktikës profesionale përmes një rregulloreje të posaçme.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka siguruar mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të zhvilluar veprimtaritë mësimore të programit të studimit Bachelor në "ShKIA". WBU ka në përdorim 3 godina, ambient parkimi dhe oborr. Godinat përmbajnë 10 salla leksioni, 10 salla seminari, 27 laboratorë nga të cilat 5 janë laboratorë informatike, salla për aktivitete të ndryshme konferenca, aktivitete promovuese, mbledhesh, etj, 1 sallë bibliotekë, dhoma studimi, kafeteri, zyra, mjedis për fotokopje, mjedis sportive, zyra për stafin, etj). GVJ vizitoi ambientet dhe konstatoi se janë të ajrosura, të ndriçuara, të bollshme, të pajisura me sistem kondicionimi dhe me infrastrukturë cilësore e moderne. Godinat janë gjithashtu të pajisura me ashensor, shkallë të brendshme dhe emergjence, rampa për personat me aftësi ndryshe si dhe plotësojnë kushtet higjeno-sanitare dhe teknike për sigurinë kundër zjarreve. <i>Evidenca 4.12-Akti higjeno sanitar; Evidenca 4.13-Akti i mbrojtjes nga zjarri;</i> <i>Evidenca 4.19-Fragmenti i Hartës Kadastrale të WBU-së;</i> <i>Tabela 16: Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB;</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës së zhvilluar, GVJ konstatoi se mjediset në dispozicion të këtij programi mësimor janë të bollshme, komode dhe të pajisura me PC, smartboards, sistem kondicionimi, sinjal WIFI, etj, të përshtatshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Mjediset laboratorike në dispozicion të programit të studimit janë të pajisura kompjutera dhe mjete të ndryshme në funksion

informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	të lëndëve të përfshira në këtë program. Mjediset e laboratorëve janë të bollshme dhe të ndriçuara në mënyrë natyrale. Laboratorët kishin kompjutera, smartboards, tabela, etj. <i>Evidenca 4.25 Lista e laboratorëve të WBU për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe IA;</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita në institucion dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, GVJ vëren se në laboratorët e inforantikës, përfshirë laboratorin e dedikuar për programin e studimit Bachelor në “ShKIA”, disponojnë pajisje hardware (kompjutera, smartboard, etj) si dhe një gamë të gjerë softuerësh specifikë si Python (Anaconda), Jupyter Notebook, TensorFlow, Keras, Scikit-learn, Pandas, NumPy, Matplotlib, Seaborn, Orange Data Mining, VS Code, Google Colab, RapidMiner Studio, Rstudio, Weka, Eclipse, MySQL, etj, të përshtatshëm dhe që mbështesin lëndët e programit të studimit. GVJ konstaton se kapacitetet teknike në laboratorë përputhen me kërkesat akademike të programit dhe mbulojnë një gamë të gjerë njohurish, nga machine learning e data science deri te inxhinieria e softuerit dhe siguria kibernetike. <i>Evidenca 4.25 Lista e laboratorëve të WBU për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe IA;</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni i arsimit të lartë disponon pesë laboratorë të teknologjisë së informacionit, të cilët u inspektuan nga GVJ gjatë vizitës në institucion. Këta laboratorë janë të pajisur me kompjuterë, smartboard dhe poste të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e studentëve të programit të studimit Bachelor në “ShKIA”. Po ashtu, bazuar në evidencën e dorëzuar, në kompjutera janë të instaluar programe software-ike specifike për programin e studimit. <i>Evidenca 4.25 Lista e laboratorëve të WBU për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe IA;</i>
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se WBU operon në formën e një kampusi me tre godina, ambiente të jashtme dhe hapësira të dedikuara për studentët. Mjediset janë të bollshme, të ajrosura, të ndriçuara natyralisht dhe të pajisura me infrastrukturë moderne e bashkëkohore.</i> <i>Në dispozicion janë salla leksioni, seminari, laboratorë, bibliotekë, ambiente për konferenca, aktivitete sociale dhe</i>

	administrative. Për programin e studimit janë në dispozicion laboratorë të teknologjisë së informacionit të pajisur me kompjuterë, smartboard, poste të mjaftueshme, si dhe programe softwareike të përshtatshme për programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi se në përgjithësi, me disa përjashtime, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar është e pesë viteve të fundit, është në përputhje me lëndën dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Megjithatë, nga shqyrtimi i inventarit të fondit të bibliotekës GVJ konstatoi se, megjithëse biblioteka përmban një fond të madh botimesh, literatura në funksion të programit të studimit, e specifikuar si e detyrueshme, e rekomanduar apo literaturë tjetër që lidhet me lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, <i>nuk është e disponueshme në bibliotekë.</i> Literatura e bibliotekës është kryesisht e fokusuar tek shkencat të tjera si mjekësi, dentistrri, infermieri, biologji, etj, ndërkohë që literatura që lidhet me shkencat kompjuterike në përgjithësi është shumë e limituar. Gjatë takimeve në institucion, si pedagogët ashtu edhe studentët konfirmuan se literatura iu vihet në dispozicion studentëve nga pedagogët në format elektronik përmes sistemit SMART WBU dhe/ose google classroom, duke siguruar që studentët të kenë në dispozicion në format elektronik literaturën e lëndëve përkatëse. Për të siguruar një qasje më të strukturuar dhe të qëndrueshme ndaj materialeve mësimore si dhe për t'u siguruar që studentët që kenë mjaftueshëm burime për të zgjeruar njohuritë e tyre në drejtim të këtij programi studimi, GVJ rekomandon që biblioteka të pasurohet me literaturë që i shërben programit të studimi, duke u fokusuar fillimisht tek literatura e detyrueshme e specifikuar në syllabuse.

	<i>Evidenca 3.3-Sylabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike;</i> <i>Evidenca 4.34-Lista e librave (Fondi i Bibliotekës;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Pas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve të programit të studimit GVJ konstaton se, në përgjithësi, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar është e përditësuar dhe i përket pesë viteve të fundit, duke i përmbushur kështu kërkesat për literaturë bashkëkohore në mbështetje të programit. Megjithatë, në disa raste konstatohet përdorimi i literaturës më të vjetër. Bazuar në <i>nenin 34</i> të Rregullores mbi organizimin administrativ të institucionit Zyra e Menaxhimit të Bibliotekës është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të titujve të ardhur në bibliotekë, si dhe për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose shënimi lidhur me fondin e bibliotekës. Referuar evidencave të paraqitura dhe diskutimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se fondi i literaturës pasurohet periodikisht sipas kërkesave dhe nevojave të njësive përgjegjëse, megjithatë, institucioni aktualisht nuk disponon një rregullore ose procedurë të shkruar që të qartësojë hapat, mënyrën e realizimit dhe afatet e këtij procesi. Në këtë kuadër, GVJ rekomandon që Institucioni të hartojë dhe të miratojë një procedurë të shkruar për pasurimin e fondit të bibliotekës, ku të përcaktohen qartë hapat, përgjegjësitë dhe afatet për përditësimin e literaturës akademike. <i>Evidenca 3.3-Sylabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike;</i> <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 4.36-Praktika e kërkesës për pasurimin e fondit të bibliotekës;</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjatë vizitës GVJ vuri re se në institucion ka një sallë biblioteke të pajisur me poste leximi, dhoma studimi, kompjutera në dispozicion të studentëve për të aksesuar bibliotekat online si dhe raftë ku janë vendosur një pjesë e librave. Biblioteka qëndron e hapur gjatë orarit zyrtar të punës, 08:30 – 16:30, dhe, me kërkesë të studentëve, mund të rrinte hapur edhe ditën e shtunë gjatë

studentët e programit të studimit.	sezonit të provimeve. Studentët asistohen nga një personel i kualifikuar dhe i dedikuar. Ambienti është i bollshëm, i ajrosur dhe i ndriçuar.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re se biblioteka është e pajisur me tekste universitare, libra, revista shkencore apo botime të tjera në gjuhë shqipe dhe të huaj, të lidhura me të gjitha programet e studimit që ofrohen në WBU. Biblioteka kishte seksion të veçantë librash në funksion të shkencave kompjuterike. Referuar RVB, biblioteka ka rreth 30.000 tituj fizik në total, nga të cilat rreth 1050 janë në funksion të këtij programi studimi. Po ashtu, referuar RVB, institucioni disponon rreth 250.000 tituj librash elektronikë. Megjithë atë, institucioni nuk ka vënë në dispozicion listën me 1050 tituj që janë në funksion të programit të studimit dhe referuar listës së librave paraqitur si evidencë, rezulton se literatura në funksion të programit të studimit është shumë e kufizuar. Biblioteka mundëson 36 burime online që mund të aksesohen nga faqja e internetit e bibliotekës¹. <i>Evidenca 4.32-Dokumenti i abonimit në JSTOR;</i> <i>Evidenca 4.33-Akresi në Research for Life;</i> <i>Evidenca 4.34-Lista e librave (Fondi i Bibliotekës;</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka ndodhet në Godinën B të kampusit dhe është e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe personeli akademik. Salla e bibliotekës është e pajisur me një numër të konsiderueshëm postesh leximi dhe kompjutera që mund të përdoren nga lexuesit për të aksesuar fondin online. Në bibliotekë janë në dispozicion edhe dhoma studimi të dedikuara që mund të përdoren nga studentët. Shërbimi i internetit WIFI ofrohet në të gjithë kampusin, përfshirë bibliotekën, pa pagesë për të gjithë studentët. Studentët mund të aksesojnë burimet elektronike, pa pagesë në të gjithë kompjuterat e lidhur në rrjetin e WBU-së, ose nëpërmjet kredencialeve të email-it. Hyrja nga jashtë perimetrit të rrjetit mundësohet "remote" pas autentikimit në pikën qendrore të regjistrimit. <i>Evidenca 4.35-Rregullorja e Bibliotekës;</i> <i>Evidenca 4.37-Rregullat e Bibliotekës në Universitetin Western Balkans;</i>

¹ <https://library.wbu.edu.al/en>

Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se biblioteka është e pajisur me kompjuterë dhe programe të nevojshme për përdorim nga studentët. WBU ka vënë në dispozicion dhe në faqe interneti të dedikuar për bibliotekën. Përveçse një burim informacioni, ambientet e bibliotekës shërbejnë edhe si hapësira studimi, të cilat janë të hapura për të gjithë studentët dhe personelin. Gjithashtu, studentët mund të marrin asistencë nga personel i dedikuar në bibliotekë.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Referuar evidencave të paraqitura konfirmuar gjithashtu edhe gjatë takimit me punonjësit e bibliotekës dhe personelin akademik, ambientet e bibliotekës janë të hapura çdo ditë javë 08:30-16:30. Gjatë sezonit të provimeve, me kërkesë të studentëve, shërbimi i bibliotekës ofrohet edhe pas këtij orari si dhe ditën e shtunë, duke iu përgjigjur kështu nevojave të studentëve. Aksesit në bibliotekat online është pa kufizim. <i>Evidenca 4.38-Praktikë për informimin e personelit akademik për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online;</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Referuar rregullores mbi organizimin administrativ të institucionit, Zyra e Menaxhimit të Bibliotekës është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të titujve të ardhur në bibliotekë, si dhe për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose shënimi lidhur me fondin e bibliotekës. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se personeli i bibliotekës informon personelin akademik, njësitë bazë dhe ato kryesore përgjegjëse për programet e studimit, mbi prurjet e reja si dhe raporton mbi cilësinë e fondit fizik, përditësimet, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe online, shfrytëzimin e sallave të studimit, etj. <i>Evidenca 4.38-Praktikë për informimin e personelit akademik për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online;</i>
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstatoi se literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar e përcaktuar në syllabuse nuk është e</i>

	<u>disponueshme në bibliotekë, por vihet në dispozicion studentëve nga pedagogët nëpërmjet sistemeve Smart WBU dhe Google Classroom. Rekomandohet që institucioni të tregojë prioritet për përfshirjen e këtyre burimeve edhe në fondin e bibliotekës. Gjithashtu, u konstatua se, edhe pse institucioni ka praktika të pasurimit të fondit të bibliotekës, ky proces nuk është i përcaktuar në asnjë rregullore dhe duhet dokumentuar si një proces i strukturuar.</u> Përsa i përket kushteve të bibliotekës, GVJ konstaton se institucioni ofron një bibliotekë bashkëkohore, me mjedise të mëdha, të ajrosura mirë dhe me infrastrukturën e duhur për përdorim. Biblioteka ofron akses të lehtë dhe pa pagesë në disa burime online për studentët, si brenda, ashtu edhe jashtë kampusit, duke mundësuar një shfrytëzim efikas të literaturës dhe burimeve akademike. WBU ka vënë në dispozicion personel të kualifikuar i cili ofron asistencë të specializuar për studentët dhe përdoruesit në shfrytëzimin e burimeve të bibliotekës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se i gjithë informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim ruhet dhe menaxhohet si fizikisht nga zyrat përkatëse ashtu edhe elektronikisht përmes sistemit të menaxhimit SMART-WBU. Sistemi mundëson automatizim të dokumentacionit dhe proceseve dhe procedurave në funksion të veprimtarive institucionale. Zyra e sekretarisë mësimore është përgjegjëse për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e regjistrimeve, informacioneve dhe dokumentave që lidhen me studentët si në format hard copy ashtu edhe elektronikisht në sistem.

	Institucioni përdor gjithashtu edhe sistem backup për të siguruar informacion elektronik të qendrueshëm. <i>Evidenca 3.38-Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore;</i> <i>Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 4.29-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU;</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	WBU përdor një sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “ShKIA”. Bazuar në rregulloren mbi organizimin administrativ të WBU, zyra e burimeve njerëzore është përgjegjëse për administrimin e këtij informacioni. Zyra mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në këtë program studimi, përfshirë personelin e angazhuar në secilin program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semester dhe vit akademik, etj. <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Referuar udhëzuesit të sistemit SMART-WBU, si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ pa një demonstrim të sistemit dhe konstatoi se sistemi siguron akses të dedikuar në përputhje me përgjegjësitë/rolet e përdoruesve. Sistemi ofron single sign-on përmes adresës zyrtare të emailit dhe secili përdorues akseson vetëm të dhëna dhe dokumenta që i përkasin përdoruesit specifik. <i>Evidenca 4.29-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU;</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet	GVJ konstatoi se sistemi SMART-WBU përmban një sërë modulesh të integruara që ofrojnë informacion të plotë për programin e studimit. Studentët aksesojnë sistemin përmes adresës së tyre të emailit dhe marrin informacion të plotë mbi programin e studimit, si syllabuset e lëndëve, vlerësimet, prezencën, materialet e lëndëve si dhe mbi çështje të tjera që mund të lidhen me sekretarinë mësimore apo zyra të tjera. Gjithashtu sistemi ka të integruar edhe mjet komunikimi

personelit akademik dhe studentëve.	interaktiv. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se veç sistemin, përdoret edhe google classroom si dhe komunikim elektronik përmes emailit.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në sistemin SMART-WBU ruhet informacion i plotë mbi programin e studimit dhe aktivitetin e studentëve dhe personelit akademik të angazhuar në program. Kjo mundëson njëkohësisht edhe monitorim në kohë reale të aktiviteteve akademike dhe administrative duke siguruar transparencë dhe efikasitet. Nga sistemi mund të gjenerohen raportimeve individuale dhe në grup dhe ky informacion i vihet në dispozicion organeve dhe autoriteteve drejtuese sipas kërkesës.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ kontrolloi faqen e internetit dhe vuri re se informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme janë të publikuara në të paktën dy gjuhë, përfshirë gjuhën shqipe ² .			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, veç administrimit fizik përmes zyrave përkatëse, siguron edhe administrim të të gjithë informacionin për studentët dhe personelin përmes sistemit SMART-WBU, duke siguruar ruajtje, akses të kontrolluar dhe monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Sistemi mundëson raportime dhe komunikim interaktiv, ndërkohë që në funksion të zhvillimit efikas të programit përdoren edhe mjete shtesë si Google Classroom dhe email zyrtar. Gjithashtu, GVJ konstaton se informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e institucionit janë publikuar në faqen zyrtare në të paktën dy gjuhë, përfshirë gjuhën shqipe, duke siguruar transparencë dhe akses të mirë për të interesuarit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

² <https://wbu.edu.al/en/program/computer-sciences-and-ai>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe në vijim të vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni harton dhe miraton çdo vit raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit ku jepet informacion i detajuar edhe mbi aktivitetin financiar të tij. WBU harton gjithashtu raporte financiare vjetore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi ku detajohen të ardhurat dhe shpenzimet për çdo zë buxhetor. Nga kontrolli i bërë rezulton se raportet financiare janë publike në faqen e QKB-së. <i>Evidenca 4.40-Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024;</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Nga shqyrtimi i raporteve vjetore të veprimtarisë së institucionit dhe pasqyrave financiare, GVJ konstaton se institucioni respekton standardet e hartimit të buxhetit dhe raportimit financiar. Hartimi i buxhetit bazohet në kërkesat/projektet që paraqiten nga njësitë para miratimit të tij. Bazuar në statut dhe rregulloret e institucionit, menaxhimi administrativ, financiar, ekonomik dhe i aseteve janë përgjegjësi e Bordit të Administrimit. Bazuar në <i>nenin 30</i> të Rregullores për organizimin administrativ, administratori i universitetit harton projektbuxhetin vjetor mbi bazën e propozimeve të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të universitetit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij. Nga analiza e veprimtarisë financiare të institucionit vërehet se institucioni ka kryer shpenzime për personelin, kërkimin shkencor, mirëmbajtje, blerje mallrash dhe shërbime, etj. Zyra e prokurimeve dhe shërbimeve administrative është përgjegjëse për realizimin e të gjitha procedurave në lidhje me furnizimin me mallra dhe shërbime, qiramarrjen dhe ndërtimet në WBU. Procedurat përcaktohen në një rregullore të posaçme. <i>Evidenca 4.41-Rregullorja e Zyrës së Prokurimeve dhe Shërbimeve Administrative, Neni 5;</i> <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i>

	<i>Evidenca 4.40-Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024;</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në statutin e WBU, neni 118 është parashikuar auditimi i jashtëm me auditues të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar nga Ministria e Financave. Institucioni nuk ka paraqitur evidencë që të dëshmojë se i është nënshtruar auditimit (të brendshëm ose të jashtëm) për gjendjen dhe aktivitetin e tij financiar për vitet e akreditimit, si dhe nuk e konfirmon këtë as në raportin e vlerësimit të brendshëm të dorëzuar. Ndërkohë, institucioni kryen auditim periodik të brendshëm ku vlerëson përputhshmërinë e dokumentacionit me kuadrin ligjor, udhëzimet, rregulloret dhe vendimet e organeve drejtuese. Evidenca e paraqitur nuk përfshin auditim të veprimtarisë financiare. Për sa më sipër GVJ rekomandon që institucioni të kryejë auditim periodik ku të vlerësojë dhe dokumentojë gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. <i>Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 4.42-Raporti i auditimit të brendshëm të WBU 2023;</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Referuar rregullores për organizimin administrativ administratori i fakultetit është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administriv të njësisë së tij kryesore. Në këtë kuadër ai mikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të fakultetit në bashkëpunim me njësitë bazë përbërëse të fakultetit, duke garantuar realizim, mbikëqyrje dhe raportim deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ te Universitetit Western Balkans;</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare	Bazuar në statut dhe rregullore, Bordi i Administrimit është përgjegjës për garantimin e qëndrueshmërisë financiare të institucionit. Refereruar dokumentacionit të DVV, GVJ vëren se institucioni tregon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e këtij programi studimi dhe ecurinë normale të tij. Gjatë të treja viteve të akreditimit, institucioni ka akorduar edhe bursa për studentët. <i>Evidenca 5.13-Lista e studentëve përfitues të bursave për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024;</i> <i>Evidenca 4.40-Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024;</i>

institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ vëren se WBU, përmes strukturave të tij, harton dhe miraton raporte vjetore financiare dhe raporte të veprimtarisë së institucionit, duke respektuar standardet e planifikimit dhe raportimit financiar sipas kuadrit ligjor. Menaxhimi financiar realizohet nga Bordi i Administrimit në bashkëpunim me administratorët dhe njësitë përkatëse, duke siguruar raportim deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Në veprimtarinë financiare të institucionit përfshihen shpenzime për infrastrukturën, kërkimin shkencor, procesin mësimor dhe shërbime të tjera mbështetëse.</i> <i>GVJ sugjeron që institucioni të vazhdojë të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm financiar dhe të marrë në konsideratë realizimin periodik të auditimeve financiare, si mjet për vlerësimin e mëtejshëm të gjendjes financiare dhe efektivitetit të saj, dhe të përcaktojë qartë në aktet e brendshme kontrollin e brendshëm financiar.</i> <i>Pasqyrat financiare reflektojnë qëndrueshmëri financiare të institucionit, duke garantuar vijimësinë e programit në të ardhmen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton një paketë aktesh të brendshme që rregullojnë procesin e pranimit, ndjekjes dhe diplomimit të studentëve, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Këto përfshijnë rregulloren për programet e ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, rregullore për njohjen dhe transferimin e studimeve, për bursat, etj. Institucioni ka dorëzuar gjithashtu edhe një rregullore për programin e studimit Bachelor në “ShKIA” por, nga verifikimi i tij, rezultoi se ky dokument nuk përmbush kriteret e nevojshme formale. Për më tepër, plan programi i përfshirë në këtë rregullore, nuk përkon me plan programin e programit të studimit bachelor në “ShKIA”, dhe me atë të publikuar në faqen e internetit³. GVJ rekomandon që institucioni të rishikojë dhe përditësojë rregulloren e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale, duke siguruar që ajo të plotësojë të gjitha kriteret formale të kërkuara dhe të harmonizohet plotësisht me planprogramin zyrtar të programit dhe me versionin e publikuar në faqen zyrtare të institucionit. <i>Evidenca 2.1. Rregullorja “Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë”;</i> <i>Evidenca 5.14-Rregullore për njohjen dhe transferimin e studimeve;</i> <i>Evidenca 5.12-Rregullorja e bursave mbi zbritjen e tarifës vjetore të Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 1.6-Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale;</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale;</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në Statutin (nenet 87-96) dhe rregulloren themelore të WBU (nenet 54-58), studimet në WBU mund t’i ndjekin studentë shqiptarë dhe të huaj. Për studentët e huaj WBU ka hartuar një procedurë specifike. Aplikimi bëhet online përmes faqes zyrtare të internetit. WBU pranon studentë bazuar në kuotat që përcaktohen çdo vit nga departamenti dhe që miratohen nga Bordi i Administrimit. Po ashtu, me miratim të

³ <https://wbu.edu.al/en/program/computer-sciences-and-ai>

	Senatit Akademik, universiteti vendos kritere pranimi shtesë për përzgjedhjen e kandidatëve. Nga momenti i regjistrimit, të gjithë studentët kanë të drejta të barabarta. <i>Evidenca 5.3-Procedura e pranimi të studentëve të huaj;</i> <i>Evidenca 5.1-Miratimi i kritereve të pranimi për programet e Ciklit të Parë dhe të Dytë të studimit në WBU; Evidenca 5.6-Kriteret e pranimi të studentëve në programin "Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjen;</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në statutin, rregulloren themelore dhe rregulloren e programeve të studimit dhe për programet e ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë të WBU përcaktohen kriteret e pranimi të kandidatëve shqiptarë dhe të huaj për pranim në këtë program studimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Institucioni mund të vendosë edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve Kriteret bëhen publike nga njësia kryesore. <i>Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë";</i> <i>Evidenca 5.6-Kriteret e pranimi të studentëve në programin "Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjen;</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit në studime, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë të përcaktuara hollësisht në rregulloret e brendshme të institucionit dhe në dokumentacionin e programit të studimit. Studentët informohen për mënyrat dhe procedurat e vlerësimit, përparimit dhe diplomimit edhe në javën e parë të ciklit të studimeve gjatë javës së orientimit akademik), si dhe në javën e parë të çdo lënde ku bëhet prezantimi i syllabusit nga pedagogu përkatës. <i>Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë";</i> <i>Evidenca 5.5-Ditët e informimit brenda institucionit për studentëtorganizimi i aktiviteteve informuese;</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik,	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVI konstatoi se kriteret e veçanta për përzgjedhjen dhe pranimin e

institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	kandidatëve në programin e studimit Bachelor në “ShKIA” përcaktohen nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe miratohen nga Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit. Në funksion të informimit të të interesuarve veprojnë një sërë strukturash brenda universitetit si Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve, Dekani i Studentëve, këshilltari akademik, koordinatori i departamentit dhe koordinatori i programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ vuri re se WBU është mjaft aktive në informimin e kandidatëve mbi ofertën e tij akademike dhe kriteret për t’u regjistruar në programet e studimit përmes pjesëmarrjes në panairë të ndryshme brenda dhe jashtë vendit si dhe përmes publikimeve në faqen zyrtare web dhe rrjeteve sociale. Një tjetër mjet që përdoret është dhe sistemi SMART-WBU ku studentët që kanë akses marrin informacion të hollësishëm mbi programet e studimit. <i>Evidenca 4.29-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU</i> <i>Evidenca 5.6-Kriteret e pranimi të studentëve në programin “Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjen;</i> <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GVJ konstaton se WBU përcakton kuota të veçanta për studentët me aftësi ndryshe, pakicat dhe shtresat e marginalizuara. Gjithashtu, institucioni organizon seminare trajnimi për ndërgjegjësimin e studentëve dhe ka ndërmarrë masa konkrete për të garantuar aksesueshmëri në ambiente, duke siguruar infrastrukturë të përshtatur, si rampa, ashensorë dhe tualete të dedikuara për personat me aftësi ndryshe. <i>Evidenca 5.8-Kuotat e parashikuara për studentët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjina;</i> <i>Evidenca 5.9. Raport Trajnimi WBU-Down Syndrome Albania;</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe nga diskutimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se WBU i kushton një rëndësi të veçantë thithjes së studentëve të huaj. Për këtë, WBU është aktive përmes pjesëmarrjes në panairë brenda dhe jashtë vendit dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione jashtë vendit. Në rregulloren themelore përcaktohen kriteret për përzgjedhjen, pranimin dhe regjistrimin e kandidatëve nga shtetet e huaja ndërsa kriteret specifike përcaktohen në një procedurë të vecantë WBU ka

	ngritur dy zyra të posaçme për studentët e huaj, Zyrën e marketingut dhe pranimeve dhe Zyrën e orientimit dhe mbështetjes së studentëve. <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 5.3-Procedura e pranimi të studentëve të huaj;</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ vuri re se WBU ofron bursa ose reduktim të tarifave të studimit për studentët, mbi bazën e disa kriterëve që përcaktohen në rregulloren e bursave. Studentëve iu mundësohen bursa ekselence, bursa institucionale si dhe bursa studimi për maturantët që vijnë nga zona të veçanta në vend. Konkretisht, për programin e studimit bachelor në "ShKIA", janë akorduar 7 bursa ekselence dhe 5 bursa institucionale për vitin akademik 2022 – 2023, 5 bursa ekselence për vitin akademik 2023 – 2024, si dhe 6 bursa ekselence për vitin akademik 2024 – 2025. <i>Evidenca 5.13-Lista e studentëve përfitues të bursave për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024;</i> <i>Evidenca 5.12-Rregullorja e bursave mbi zbritjen e tarifës vjetore të Universitetit Western Balkans;</i>
Konkluzione	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se WBU ka hartuar dhe zbaton një paketë të plotë aktesh të brendshme që mbulojnë ciklin akademik të studentëve nga pranimi deri në diplomim, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, GVJ evidenton si nevojë rishikimin e rregullores së programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale për të siguruar përputhshmëri të plotë me kurrikulën zyrtare dhe përmbushje të kriterëve formale. Gjithashtu, institucioni garanton barazi të të drejtave për të gjithë studentët dhe kandidatët, duke ofruar kriterë të qarta dhe procedura të publikuara për pranimin, përparimin dhe diplomimin. WBU është aktive në informimin e publikut mbi ofertën akademike dhe kriteret përkatëse përmes panairove, publikimeve online dhe strukturave të brendshme institucionale. Po ashtu, GVJ konstatoi se WBU përcakton kuota dhe politika mbështetëse për studentët me aftësi ndryshe, pakicat dhe grupet e marginalizuara, ofron bursa për

	<i>studentët, si dhe ndjek një qasje proaktive për përthithjen e studentëve të huaj.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar statutit (neni 84), rregullores themelore të institucionit (neni 90), dhe rregullores për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë (nenet 20-23), si dhe nga shpjegimet e dhëna gjatë vizitës në institucion dhe diskutimit me studentët, GVJ vlerëson se studentët kanë informacion të plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik si dhe kalimi nga njëri vit akademik në tjetrin. <i>Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans; Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë";</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ vëren se në WBU çdo i interesuar informohet mbi kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme nga zyrat përkatëse që në momentin e interesimit dhe paraqitjes së kërkesës për regjistrim. Kriteret dhe procedurat janë të përcaktuara në statut, rregulloren themelore si dhe në rregulloren për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë. Ndërkohë, WBU ka të miratuar edhe një rregullore specifike ku detajohen kriteret dhe procedurat për njohjen dhe transferimin e studimeve. Për njohjen e krediteve ngrihet një komision ad-hoc nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. Një informacion i përgjithshëm është gjithashtu i publikuar edhe në faqen e internetit të WBU ⁴ <i>Evidenca 1.1-Statuti i Universitetit Western Balkans; Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i>

⁴ <https://wbu.edu.al/en/transfer-wbu>

	<i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë";</i> <i>Evidenca 5.14-Rregullore për njohjen dhe transferimin e studimeve;</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët kanë informacion të plotë mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive. Ky informacion është i përcaktuar në Rregulloren themelore të universitetit dhe në rregulloren për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë. Gjithashtu, kriteret, komponentët dhe mënyra e vlerësimit përcaktohen në syllabusin e secilës lëndë, e cila iu prezantohet studentëve në javën e parë të lëndës nga lektori përkatës. Syllabusi është i aksesueshëm nga studentët në çdo kohë përmes sistemit SMART-WBU dhe/ose google classroom. <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë";</i> <i>Evidenca 3.3-Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike;</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një dokument specifik për punimin e diplomës. Diploma është e përcaktuar si lëndë e veçantë në plan program e shoqëruar me syllabusin përkatës ku përcaktohen detaje të hollësishme mbi modalitetet e saj. Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit janë të përcaktuara edhe në statut, rregulloren themelore dhe rregulloren për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë. Për punimin e diplomës studentët mund të marrin gjithashtu informacion edhe nga drejtuesit e njësisë bazë, koordinatorët dhe këshilltarët akademik për çdo grup. <i>Evidenca 3.35-Manuali për punimin e diplomës;</i> <i>Evidenca 3.36-Syllabus i lëndës "Temë diplome" për programin "Bachelor në Shkenca Kompjuterike;</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit konfirmuar edhe nga takimet e zhvilluara në institucion, GVJ vuri re se institucioni është vazhdimisht i angazhuar për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm përmes aktiviteteve të ndryshme që

lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	organizon si Ditët e hapura të informimit, pjesëmarrja në panairë brenda dhe jashtë vendit, etj. Zyra e Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimi të Studentëve është përgjegjëse dhe mjaft aktive në informimin e të interesuarve, prezantimin e WBU në aktivitete të ndryshme dhe përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve promovuese. WBU është po ashtu aktive edhe në web përmes publikimit të informacioneve në faqen zyrtare të internetit dhe rrjetet sociale. Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve organizon javën orientuese për studentët e rinj çdo fillim viti akademik. <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 5.5-Ditët e informimit brenda institucionit për studentët organizimi i aktiviteteve informuese;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni u ofron studentëve informacion të plotë dhe të qartë mbi ecurinë akademike, mënyrat e njohjes dhe vlerësimit të dijeve përgjatë gjithë ciklit të studimeve deri në diplomim. Ky informacion përfshihet në akte të brendshme të institucionit dhe në dokumentacion specifik të përgatitur për këtë qëllim, i cili është lehtësisht i aksesueshëm për studentët nëpërmjet platformave dhe shërbimeve informuese të dedikuara.</i> <i>Përveç kësaj, institucioni ka krijuar mekanizma të posaçëm për këshillim dhe informim të vazhdueshëm për studentët dhe palët e tjera të interesuara, që funksionojnë si para fillimit të vitit akademik ashtu edhe gjatë zhvillimit të tij. Një praktikë e mirë është pjesëmarrja e rregullt në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në promovimin e programeve të studimit dhe ka kontribuar në rritjen e numrit të studentëve të huaj të regjistruar, duke nxitur progres të prekshëm në fushën e ndërkombëtarizimit të institucionit.</i> <i>Gjithashtu, institucioni ka përcaktuar qartë kriteret e pranimit dhe procedurat për transferimin e studimeve, duke garantuar transparencë dhe barazi në trajtimin e kërkesave të studentëve. Studentëve u vihet në dispozicion edhe një dokument udhëzues për punimin diplomës, i cili shërben si mjet orientues për strukturimin dhe përfundimin me sukses të këtij procesi akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentave dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se studentët marrin informacion të plotë mbi programin e studimit që në fillim të vitit akademik. Informacion lidhur me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen, vlerësimin me kredite, etj, gjendet në kurrikulën e programit të studimit si dhe është i publikuar edhe në faqen web⁵. Informacioni u jepet studentëve edhe fizikisht (i printuar) nga sekretaria mësimore. Në aktet e institucionit (statut, rregullore themelore dhe rregulloren për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të dytë) përcaktohen gjithashtu forma e organizimit të studimeve, mënyra, gjuha e programit, viti akademik, etj. Çdo departament cakton një këshilltar akademik për çdo program studimi të cilët kanë një rol të rëndësishëm për orientimin dhe adresimin e problematikave që ngrihen nga studentët. <i>Evidenca 5.17-Praktika e informimit të studentëve nga këshilltari akademik;</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale;</i> <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë";</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ vëren se institucioni përdor disa mekanizma për t'u siguruar që studentët e programit të studimit të kenë informacion të detajuar mbi të. Këshilltari akademik ka një rol mjaft aktiv në informimin dhe orientimin e studentëve. Studentët mund të marrin informacion në sekretarinë mësimore dhe po ashtu edhe përmes faqes web të institucionit. Syllabuset përmbajnë informacion të hollësishëm për lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese dhe iu prezantohen studentëve në javën e parë të lëndës. I gjithë dokumentacioni/udhëzuesit është i aksesueshëm nga studentët në çdo kohë përmes sistemit SMART-WBU.

⁵ <https://wbu.edu.al/en/program/computer-sciences-and-ai>

	<i>Evidenca 4.29-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU;</i> <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë";</i> <i>Evidenca 5.17-Praktika e informimit të studentëve nga këshilltari akademik;</i> <i>Evidenca 3.3-Sylabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike;</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Referuar nenit 47 të rregullores mbi organizimin administrativ të WBU, Zyra e Planifikimit të Karrierës është përgjegjëse për të asistuar studentët në planifikimin e karrierës së tyre, integrimin në tregun e punës dhe për të krijuar lidhje me institucione e kompani të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, Zyra ofron gjithashtu këshillim individual si dhe organizon trajnime për përgatitjen e CV-ve, letrave të interesit, procesin e intervistës dhe tema të tjera që përgatisin studentët për tregun e punës. Paralelisht, kjo zyrë organizon edhe aktivitete të tilla si workshope të karrierës, panairin e punës, etj. Në WBU funksion programi EPIC që ndihmon studentët për të bërë internship-e GVJ u informua gjithashtu se në WBU është ngritur zyra e të diplomuarve, e cila do të nisë funksionimin pasi të dalë brezi i parë i të diplomuarve dhe do të shërbejë si një urë lidhëse mes universitetit, të diplomuarve dhe tregut të punës. <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 5.18-Praktika e një rasti këshillimi karriere nga Zyra e Planifikimit të Karrierës;</i> <i>Evidenca 1.19-Manuali i EPIC për programin "Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale";</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, GVJ vëren se ata kanë informacionin e duhur për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e ofruara. Ky informacion iu vihet në dispozicion që me nisjen vitit akademik. Studentët pajisen me guidën e studentit (STUDENT Handbook Duolanguage) e cila është gjithashtu e aksesueshme në web⁶. GVJ vëren se faja web është e pasur me informacion për studentët⁷. Po ashtu studentët marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme nga

⁶ <https://campuslife.wbu.edu.al/en/student-handbook>

⁷ <https://campuslife.wbu.edu.al/en>

	këshilltarët akademikë, koordinatorët e programeve të studimit, sekretaria mësimore si dhe përmes sistemit SMART-WBU.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në institucion funksionon sistemi SMART-WBU në të cilin ndodhet i gjithë informacioni në lidhje me procesin mësimor. Çdo student pajiset me një llogari personale, përmes së cilës akseson këtë sistem sipas privilegjeve që i jepen. Sistemi i mundëson studentit të marrë informacion edhe në distancë. <i>Evidenca 4.29-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU;</i>			
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se WBU, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në "ShKIA" informacion të hollësishëm mbi objektivat formuese, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit.</i> <i>Studentëve iu ofrohen manuale dhe udhëzues të posaçëm, që përmbajnë informacion të detajuar për lëndët, aktivitetet formuese dhe mundësitë akademike. Përmes strukturave administrative dhe shërbimeve si Zyra e Planifikimit të Karrierës, këshilltarët akademikë, koordinatorët e programeve të studimit, studentët informohen mbi mundësitë e punësimit dhe orientimin në tregun e punës.</i> <i>Programi EPIC është një nismë që ndihmon studentët në planifikimin e karrierës së tyre dhe përgatitjen për tregun e punës.</i> <i>Sistemi i menaxhimit të informacionit SMART-WBU i mundëson studentëve akses online dhe në distancë për të marrë informacionin mbi zhvillimin e procesit mësimor dhe aktivitete të tjera akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Referuar dokumentacionit dhe pas vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni disponon statistika lidhur me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit. Ky informacion iu vu në dispozicion GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore. <i>Evidenca 5.19-Lista e studentëve të programit të studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjenc; Evidenca 4.40-Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024;</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqjet nga programi, largimet, pezullimet etj. Ky informacion pasqyrohet në raportet vjetore të njësisë bazë dhe njësisë kryesore si dhe disponohet dhe administrohet nga Sekretaria mësimore në regjistrat e posaçëm. Të dhënat në regjistrat përpunohen dhe përditësohen, sipas proceseve institucionale. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike të verifikuara nga GVJ edhe në regjistrin themeltar në sekretarinë mësimore, janë si më poshtë: • 2022-2023: 13 studentë të regjistruar nga të cilët 2 të çregjistruar; • 2023-2024: 9 studentë të regjistruar nga të cilët 3 të çregjistruar; • 2024-2025: 30 studentë të regjistruar; <i>Evidenca 4.40-Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024;</i> <i>Evidenca 1.22-Raporti i punës kërkimore-shkencore i Departamentit të Teknologjisë dhe Biznesit;</i> <i>Evidenca 3.38-Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore;</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Bazuar në rregulloren mbi organizimin administrativ, neni 31 dhe rregulloren e sekretarisë mësimore si dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se WBU ruan të dhëna elektronike në sistemin e menaxhimit të brendshëm SMART-WBU lidhur me ecurinë e studentëve gjatë gjithë ciklit të programit të studimit, që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Në sistemin ruhen të dhëna të tilla si prezenca, vlerësimi, stadi ku ndodhet studenti, etj. Sekretaria mësimore disponon regjistrin bazë të studentëve me të dhënat e tyre personale dhe regjistrin bazë fizik dhe elektronik për vlerësimet e marra të

	cilat iu vunë në dispozicion për verifikim GJV-së gjatë takimit. Aksesit në sistem është me nivele sigurie dhe sipas roleve të përdoruesve, duke garantuar që të dhënat të aksesohen vetëm nga personel i autorizuar. <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 3.38-Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore;</i> <i>Evidenca 4.29-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU;</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se WBU bën kontroll periodik të veprimtarisë lidhur me përputhshmërinë dhe zbatueshmërinë e dokumentacionit me kuadrin ligjor, udhëzimet, rregulloret dhe vendimet e organeve drejtuese. Megjithatë, nuk është paraqitur asnjë evidencë mbi kontrollin e saktësisë së informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtaritë e tyre. Gjithashtu, në dokumentacionin e dorëzuar nuk rezultojnë të ketë asnjë procedurë, rregullore apo nen të dedikuar në aktet ekzistuese që të përcaktojnë qartë strukturat përgjegjëse, procedurat, metodologjinë dhe frekuencën e kontrollit. Me qëllim që ky proces të jetë periodik dhe formal, GJV rekomandon që institucioni të hartojë një procedurë specifike ose ta përfshijë këtë në aktet ekzistuese, duke saktësuar mekanizmin, përgjegjësitë dhe frekuencën e kontrollit periodik për vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes dhe saktësisë së informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtaritë e tyre përkatëse. <i>Evidenca 4.42-Raporti i auditimit të brendshëm të WBU 2023;</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar GJV vëren se raporti paraqet të dhëna mbi cilësinë në hyrje dhe ecurinë vjetore të studentëve që ndjekin programin e studimit bachelor në ShKIA. Raporti nuk përmban të dhëna në dalje apo të shkallës së punësimit të tyre duke qenë se nuk ka ende të diplomuar nga ky program. Referuar rregullores mbi organizimin administrativ dhe rregullores së sekretarisë mësimore, sekretaria mësimore dhe zyra e të diplomuarve janë përgjegjëse për ofrimin e statistikave mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve dhe shkallën e tyre të punësimit. <i>Evidenca 4.40-Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024;</i>

	Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans; Evidenca 3.38-Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore;			
Konkluzione	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës së kryer, GVJ ka konstatuar se institucioni, vë në dispozicion struktura të posaçme për mbledhjen, përditësimin dhe ruatjen e të dhënave mbi numrin e studentëve të regjistruar, diplomuar, transferuar, çregjistruar, etj. Të dhënat ruhen në regjistër si dhe elektronikisht përmes sistemit të menaxhimit SMART-WBU dhe janë të sigurta dhe të verifikueshme. <u>GVJ sugjeron</u> që institucioni të kryejë dhe dokumentojë kontrollin periodik të njësive përgjegjëse për menaxhimin e këtyre të dhënave. Institucioni mban të dhëna për cilësinë në hyrje dhe ecurinë vjetore të studentëve në programin e studimit Bachelor në "ShKIA" si dhe e ka të rregulluar në aktet e brendshme organizimin dhe përgjegjësitë për mbledhjen e të dhënave mbi cilësinë në dalje të studentëve dhe gjurmimin e të diplomuarve, përmes strukturave të përcaktuara përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese është i parashikuar në aktet e brendshme të institucionit. Në nenin 110 të rregullores themelore përcaktohet e drejta e organizimit të studentëve në këshilla studentorë dhe përfshirja e tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Studentët janë të përfshirë në Senatin akademik si dhe në organe të tjera kolegjiale. Studentët organizohen lirisht në Këshillin studentor, si dhe në klube studentore në fusha të ndryshme.

	<i>Evidenca 5.22-Praktika e Zgjedhjeve e Këshillit Studentor;</i> <i>Evidenca 5.24-Ngritja, funksionimi dhe përbërja e këshillit studentor;</i> <i>Evidenca 5.23-Raporti i aktiviteteve të Klubeve Studentore 2022-2023 dhe 2023-2024;</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 5.20-Pjesëmarrja e studentëve në organet kolegjiale;</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar si dhe nga diskutimet e zhvilluara me studentët gjatë vizitës në institucion, GVI konstaton se studentët janë të përfshirë në mënyrë reale dhe frytdhënëse në vendimarrje, këshillim dhe vlerësimin e procesit akademik. Këshilli studentor është organ i pavarur dhe është i angazhuar në përfaqësimin e interesave të studentëve. Studentët dëshmuar se bëjnë takime të vazhdueshme me personelin akademik gjatë të cilave diskutojnë mbi çështje që ndryshme si dhe treguan raste konkrete kur çështjet e ngritura në këto takime ishin adresuar nga strukturat përkatëse në institucion. <i>Evidenca 5.24-Ngritja, funksionimi dhe përbërja e këshillit studentor;</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVI vëren se angazhimi i studentëve përmes vlerësimeve periodike mbi performancën e pedagogëve, përmbajtjen e lëndëve, dhe pjesëmarrjes së tyre në mbledhjet e organizuara nga departamenti, u jep studentëve mundësinë të shprehen dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo rishikimit të programeve të studimit. Studentët kanë gjithashtu mundësi të paraqesin mendimet e tyre edhe duke komunikuar drejtpërdrejt me pedagogët, koordinatoren e programit të studimit, këshilltarin akademik, etj. <i>Evidenca 3.13-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik 2023-2024;</i> <i>Evidenca 5.25-Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit në Njesinë Bazë;</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe sipas diskutimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVI konstatoi se studentëve iu mundësohet dhënia e mendimit mbi veprimtaritë e procesit mësimor. Kjo garantohej nga rregullorja për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, ku sanksionohet e drejta e studentit për t'u njohur me vlerësimin e detajuar të provimit, ankimit dhe rezultatit, rishikimin dhe reflektimin nga ana e pedagogut

rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	përgjegjës. Në rast ankimimi, procedura që ndiqet është transparente dhe vlerësimi bëhet përmes një komisioni ad-hoc prej 3 vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Brenda 15 ditësh studenti njihet me vendimin. <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë";</i>			
Konkluzione	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse është reale, konkrete dhe frytdhënëse dhe garantohet nga aktet e brendshme nënligjore. Studentët përfshihen në procesin e hartimit/rishikimit të programeve mësimore, vlerësimin e veprimtarive të procesit akademik, etj, përmes disa mënyrave, si mbledhjet e departamentit, vlerësimet periodike për performancën e pedagogëve, përmbajtjen e lëndëve, etj. Procesi i vlerësimit është transparent dhe studentët kanë mundësi për t'u njohur me vlerësimin e detajuar, të marrin sqarimet e duhura dhe të ankimojnë vlerësimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se WBU ka ngritur njësi të posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në varësi të Dekanatit të Studentëve. Dekanati i studentëve është përgjegjës për mbarrëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me WBU, ndërsa zyrat në varësi përfshijnë zyrën e orientimit dhe mbështetjes së studentëve zyrën e shërbimit psiko-social dhe shëndetësor, zyrën e bursave, zyrën e koordinimit të klubeve studentore, zyrën e planifikimit të karrierës dhe zyrën e të diplomuarve. Po ashtu, në shërbim të studentëve janë edhe sekretaria mësimore, zyra e burimeve njerëzore dhe zyra të tjera që ofrojnë informacione dhe shërbime specifike për studentët.

	Veprimtaria, detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre zyrave përcaktohen në rregulloren themelore dhe rregulloren e organizimit administrativ të institucionit dhe, sipas rastit, me akte të tjera të brendshme Sistemi i menaxhimit të brendshëm SMART-WBU është gjithashtu një mjet që shërben për të informuar dhe ofruar shërbime studentëve. Ruajtja, përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave rregullohet përmes rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. <i>Evidenca 3.37. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Siç u evidentua edhe në kriterin e mësipërm, në WBU funksionojnë disa njësi që kujdesen për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe i asistojnë në çështje të ndryshme lidhur me procesin mësimor dhe zhvillimin e karrierës. WBU tregon kujdes të veçantë për studentët e huaj, për të cilët ka në funksion zyrën e studentëve ndërkombëtar që i ofron informacion dhe asistencë studentëve të huaj jo vetëm për jetën universitare por edhe për specifikat e vendit, kulturën, akomodimin, etj. GJV ka konstatuar gjithashtu se një mjet i rëndësishëm informimi është edhe faqja zyrtare e internetit dhe llogaritë në rrjetet sociale, ku publikohen njoftime, thirrje publike, aktivitete, informacione mbi programet e studimit, etj. Platformat SMART-WBU dhe google classroom ofrojnë gjithashtu informacion dhe materiale për studentët. Siç dhe u demonstrua gjatë takimit, aksesit në këto platforma mundësohet me single sign-on përmes adresës zyrtare të email-t me të cilën pajiset çdo student. Rol të rëndësishëm për informimin dhe këshillimin e studentëve luan edhe këshilltari akademik.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim	Zyra e planifikimit të karrierës, nën varësinë e Dekanatit të Studentëve, është zyrë e dedikuar për orientimin dhe këshillimin e karrierës për studentët. Zyra ka rol kyç në krijimin e lidhjeve mes universitetit dhe institucioneve publike dhe private brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu kjo zyrë ndihmon studentët për t'u përgatitur për aplikime pune. Shërbimet ofrohen si në mënyrë individuale ashtu edhe në grup. Veç sa më sipër, zyra organizon edhe aktivitete me në fokus karrierën si panairi i punës, workshop-e karriere, etj.

të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Programi EPIC është një nismë e vlefshme për të përgatitur studentët për tregun e punës dhe për të aplikuar në praktikë njohuritë që fitojnë. Deri më tani nga ky program kanë përfutur tre studentë të programit të studimit bachelor në ShKIA. <i>Evidenca 1.28-Lista e studentëve përfutues të programit EPIC 2022-2023 me praktikë të paguar;</i> <i>Evidenca 5.18-Praktika e një rasti këshillimi karriere nga Zyra e Planifikimit të Karrierës;</i> <i>Evidenca 5.18-Praktika e një rasti këshillimi karriere nga Zyra e Planifikimit të Karrierës;</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Programi i studimit Bachelor në ShKIA nuk ka ende të diplomuar, megjithë atë WBU ka themeluar zyrën e të diplomuarve, në varësi të Dekanatit të Studentëve e cila do të gjurmojë studentët e diplomuar, do të mbledhë dhe përpunojë të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit si dhe do të organizojë aktivitete të ndryshme me alumni. <i>Evidenca 1.18-Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</i>
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GJVJ ka konstatuar se në WBU janë ngritur dhe janë funksionale procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin dhe këshillimin në karrierë të studentëve. Këto zyra janë nën varësi të Dekanatit të Studentëve dhe luajnë një rol të rëndësishëm, duke qenë mjaft aktive dhe efikente. Gjithashtu, institucioni ka ngritur një zyrë të veçantë për marrëdhëniet me studentët ndërkombëtarë, e cila angazhohet në mënyrë të dedikuar me studentët e huaj, duke ofruar asistencë dhe shërbime të posaçme për këtë kategori.</i> <i>Procesi i informimit realizohet përmes zyrave të posaçme si dhe në mënyrë elektronike përmes sistemit të brendshëm, emailit, website-it, rrjeteve sociale, etj. Këshilltari akademik është gjithashtu mjaft i angazhuar dhe i përfshirë në ofrimin e informacionit, këshillimin dhe orientimin e studentëve. Institucioni ka ngritur zyrën e të diplomuarve e cila, me diplomimin e brezit të parë të studentëve bachelor, do të mbledhë, ruajë dhe përpunojë të dhëna për studentët dhe punësimin e tyre.</i>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Pas shqyrtimit të dokumentave të DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se WBU i kushton rëndësi aftësisht dhe nxitjes së personelit akademik për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Personeli trajnohet për metodat e mësimdhënies, përdorimin e teknologjive, kapacitimin për angazhime në projekte dhe veprimtari të tjera, proceset e ndryshme administrative, etj. Po ashtu, referuar syllabuseve dhe kurrikulës së programit të studimit bachelor në “ShKIA”, vërehet se procesi mësimor përdor një kombinim të metodave të ndryshme, përfshirë laboratorë, detyra kursi e projekte, vizita studimore në terren, etj. Përdorimi i pajisjeve teknologjike si smartboard sjell gjithashtu përparësi të konsiderueshme në procesin mësimor dhe angazhimin e studentëve. Planifikimi i trajnimeve merr në konsideratë nevojat e personelit akademik, të cilat mbledhen përmes pyetësorëve për zhvillimin profesional të personelit. <i>Evidenca 6.1-Pyetësor për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrativ. Paketa e instrume;</i> <i>Evidenca 1.16. Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2023-2024 dhe planifikimi i ri vjetor;</i> <i>Evidenca 3.1-Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien;</i> <i>Evidenca 1.9-Kurrikula e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale;</i>

	<i>Evidenca 3.3-Sylabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit "Bachelor në Shkenca Kompjuterike;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara me personelin akademik dhe përfaqësues të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ vëren se personeli akademik dhe ndihmësakademik i nënshtrohet vlerësimeve periodike të formave të ndryshme. Instrumentat që përdoren janë të përcaktuar në paketën e instrumentave të cilësisë. Bazuar në këtë paketë mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit përfshijnë vlerësim të personelit akademik nga studentët, vetëvlerësim të performancës së personelit si dhe vlerësim të personelit nga kolegët, praktikë kjo e huazuar nga universitete të huaj. Në WBU është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit, i cili bashkërendon punën me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Mënyra e operimit të këtyre strukturave rregullohet me rregullore të posaçme. Monitorimi, vlerësimi dhe analizimi i rezultateve janë procese periodike që përcaktohen në planin e aktiviteteve të NJSBC. <i>Evidenca 3.19-Plani i aktiviteteve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>Evidenca 6.2-Paketa e instrumenteve të cilësisë; Evidenca 6.4-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik;</i> <i>Evidenca 3.14-Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë;</i> <i>Evidenca 3.15-Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e S;</i> <i>Evidenca 3.16-Vendimi për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC);</i> <i>Evidenca 3.17-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC;</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies. Kjo mundësohet përmes pyetësorëve, i cili zhvillohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri. Përmes këtyre pyetësorëve, studentët vlerësojnë performancën e lektorit dhe përmbajtjen e lëndës. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit si dhe vetë pedagogëve në mënyrë të personalizuar E drejta e studentëve për ankimim parashikohet në aktet e brendshme të institucionit. Bazuar në këto akte, studentët mund të paraqesin ankesë për vlerësimin në provim, brenda një jave

	pasi janë njohur me vlerësimin. Ankimi shqyrtohet nga një komision <i>ad-hoc</i> i ngritur nga departamenti dhe vendimi i bëhet i ditur studentit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rishikim. <i>Evidenca 6.2-Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 6.3-Formulari i vlerësimit të lëndës nga studentët. Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm;</i> <i>Evidenca 6.4-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik;</i> <i>Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë";</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, faqes zyrtare të internetit dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se NJSBC vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të universitetit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Këto raporte i shpërndahen organeve drejtuese dhe publikohen edhe në web.⁸ Raportet shoqërohen me rekomandime përkatëse mbi bazën e të cilave njësitë e tjera hartojnë një plan masash. NJSBC organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. <i>Evidenca 6.6-Rast i një veprimtarie të organizuar për informim dhe ndërgjegjësim për sigurimin e cilësisë;</i> <i>Evidenca 6.4-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik;</i> <i>Evidenca 6.5 Rast i planit të masave të ndërmarra nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC;</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ vlerëson se në WBU promovohen shembuj të praktikave më të mira dhe personeli akademik nxitet për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Ndarja e eksperiencave mes kolegëve përmes leksioneve të hapura që zhvillohen çdo vit është një teknikë efektive, konfirmuar kjo edhe gjatë takimit me personelin akademik gjatë vizitës në institucion. GVJ vlerëson po ashtu se WBU ndjek, zbaton dhe nxit promovimin e personelit, si dhe mbështet edhe financiarisht zhvillimin e tyre akademik e professional.

⁸ iqau.wbu.edu.al/sq/documents-2022-2023




	<i>Evidenca 4.14- Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;</i> <i>Evidenca 3.11-Udhëzimi për Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor;</i> <i>Evidenca 3.12. Praktikë e mbështetjes financiare të personelit për publikime në revista të indeksuara; Evidenca 6.9-Model aplikimi për projekt (AKKSHI & QU-SURE;</i>			
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se WBU dëshmon angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, duke hartuar udhëzues institucionalë dhe duke trajnuar personelin për përdorimin e metodave bashkëkohore e inovative. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe strukturat përgjegjëse realizojnë monitorim dhe vlerësime periodike për personelin akademik dhe ndihmësakademik, duke përdorur instrumente të standardizuara, si vlerësime nga studentët, vetëvlerësim dhe vlerësime kolegësh. Rezultatet e vlerësimeve analizohen dhe shoqërohen me rekomandimet përkatëse të cilat kthehen në plane masash nga njësitë përkatëse.</i> <i>Studentët janë të përfshirë në mënyrë të rregullt në vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe performancës së stafit përmes pyetësorëve periodikë dhe kanë të drejtën e ankimimit për vlerësimet e tyre, të rregulluar me akte të brendshme. WBU promovon shembuj të praktikave të mira, promovon stafin mbi bazë performance si dhe mbështet financiarisht dhe profesionalisht zhvillimin akademik të stafit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se WBU ka ngritur struktura përgjegjëse për SBC. Referuar statutit të institucionit, organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për SBC është Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të

(SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Cilësisë Institucionale. Veprimtaria dhe detyrat e komisionit përcaktohen me rregullore të posaçme. Po ashtu, është ngritur edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila është përgjegjëse për kryerjen e vlerësimeve periodike nëpërmjet instrumentave të cilësisë. NJSBC ka në përbërje 5 anëtarë. Funksionimi dhe organizimi i NJSBC rregullohet me një rregullore të posaçme. Institucioni ka hartuar një paketë instrumentash të cilësisë përmes të cilave kryen vlerësime periodike, si dhe politika të qarta të përcaktuara në planin e tij strategjik. <i>Evidenca 6.2-Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 1.4-Plani Strategjik i WBU 2023-2030;</i> <i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Western Balkans; Evidenca 3.14-Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë; Evidenca 3.15-Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e S;</i> <i>Evidenca 3.16-Vendimi për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC);</i> <i>Evidenca 3.17-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se WBU ka ngritur Komisionin e Përhershëm të SBC. Komisioni funksionon mbi bazë të parimeve të përcaktuar në statutin e WBU dhe rregullores për veprimtarinë e tij. Po ashtu, është ngritur dhe NJSBC përgjegjëse për kryerjen e vlerësimeve. Përfshirja e studentëve sigurohet përmes të qenurit anëtarë të Komisionit dhe NJSBC, si dhe përmes pjesëmarrjes në mbledhje, pyetësorë, etj. Anëtar i Komisionit dhe NJSBC është edhe një ekspert i jashtëm. GVJ vëren se institucioni realizon vlerësime periodike për performancën akademike, vlerësimin e lëndëve, vlerësimin e personelit, institucionit, etj, përmes paketës së instrumentave të cilësisë dhe i përdor këto vlerësime për përmirësimin e cilësisë përmes dhënies së rekomandimeve dhe hartimit dhe ndjekjes së planit vjetor të masave, si dhe zbaton një strategji institucionale të përfshirë në planin strategjik të institucionit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>Evidenca 1.4-Plani Strategjik i WBU 2023-2030;</i> <i>Evidenca 3.14-Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë;</i>

	<i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Western Balkans; Evidenca 3.15-Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e S;</i> <i>Evidenca 3.16-Vendimi për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC);</i> <i>Evidenca 3.17-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC;</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se institucioni përdor instrumenta dhe tregues efektiv për sigurimin e cilësisë, të cilat përfshijnë procesin mësimor, programet lëndore, performancën e personelit, vlerësimet, etj. Institucioni i zbaton këto instrumenta periodikisht dhe ndërmer masa konkrete për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Për sigurimin e jashtëm të cilësisë, WBU i është nënshtruar proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional, dy programeve të ciklit të dytë të studimeve si dhe është në proces të akreditimit të programeve të tjera të studimit. <i>Evidenca 6.2-Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 3.13-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik 2023-2024;</i> <i>Evidenca 3.19-Plani i aktiviteteve të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>Evidenca 6.5 Rast i planit të masave të ndërmarra nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC;</i> <i>Evidenca 3.18-Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC;</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i akteve dhe praktikave të paraqitura në DVV, GVJ konstaton se institucioni, përmes NJSBC, ndërmer në mënyrë periodike aktivitete monitoruese dhe vlerësuese për institucionin, proceset dhe përmbajtjen akademike dhe performancën e personelit. NJSBC operon mbi bazën e një plani vjetor aktiviteteve. Instrumentat e përdorur të cilësisë përmbajnë tregues të matshëm që i mundësojnë NJSBC-së të bëjë analiza të të dhënave të mbledhura dhe të përpilojë raportet përkatëse. Bazuar në rezultatet, NJSBC rekomandon detyra të cilat përkthehen në plan masash dhe ndiqen nga organet drejtuese dhe njësitë përgjegjëse. Rezultatet e performancës përdoren për promovim të personelit bazuar në rregulloren mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit. WBU zbaton gjithashtu edhe udhëzimin për nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor, i cili është një tjetër

	mekanizëm që nxit zhvillimin akademik dhe rritjen e performancës së personelit. <i>Evidenca 4.14- Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;</i> <i>Evidenca 3.11-Udhëzimi për Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor;</i> <i>Evidenca 3.17-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC;</i> <i>Evidenca 6.2-Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 3.19-Plani i aktiviteteve të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstoi se institucioni ka politika dhe struktura të qarta për SBC, në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore institucionale. Institucioni zbaton një strategji për SBC, të inkorporuar në planin strategjik institucional dhe një sistem të qëndrueshëm për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, duke përdorur instrumente dhe tregues të qartë për vlerësimin e programeve të studimit, procesit mësimor, performancës së personelit akademik, ndihmësakadmik dhe administrativ, dhe vetë institucionit.</i> <i>GVJ vlerëson se përfshirja e studentëve në SBC është efektive dhe garantohet përmes të qënurit anëtarë në Komisionin SBC dhe NJSBC. Ata kontrobuojnë në mënyrë aktive përmes pjesëmarrjes në sondazhe, në mbledhjet e departamentit, takimet individuale me personelin, etj.</i> <i>Po ashtu, institucioni i është nënshtruar proceseve të akreditimit të jashtëm institucional dhe të dy programeve studimi. Rezultatet e vlerësimeve analizohen dhe i përcillen autoriteteve drejtuese dhe pedagogëve për përmirësime të mëtejshme. WBU ndjek politika për promovimin dhe zhvillimin profesional dhe akademik të personelit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe në vijim të vizitës në institucion, GVJ vëren se WBU ka në funksion procese të dokumentuara periodike për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit Bachelor në “ShKIA”. Institucioni vlerëson në mënyrë periodike performancën e personelit të angazhuar në programin e studimit nga kolegët dhe studentët, vlerësimin e lëndëve nga studentët, vlerësimin e programit të studimit nga studentët e diplomuar si dhe komponentë të tjerë të përfshirë në paketën e instrumentave të cilësisë. NJSBC harton raporte në të cilat përfshin rekomandime që rrjedhin nga rezultatet e vlerësimeve të të gjithë komponentëve. Ato iu shpërndahen organeve drejtuese dhe atyre përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. <i>Evidenca 6.16-Raporti i vlerësimit të institucionit nga personeli për vitin akademik 2022-2023 2023-2024;</i> <i>Evidenca 6.2-Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se NJSBC harton raporte ku paraqiten rezultatet për secilin komponent të vlerësuar për secilin program studimi, përfshirë programin e studimit Bachelor në “ShKIA”. Rezultate e këtyre vlerësimeve bëhen gjithashtu pjesë e raporteve vjetore, të cilat përmbajnë rekomandime. Këto përdoren nga institucioni dhe kthehen në plane masash dhe ndiqen nga organet përkatëse. Arritjet e evidentuara përdoren për të promovuar praktikën më të mira, sipas parashikimeve në rregulloret dhe udhëzimet përkatëse. Studentët me arritje të larta motivohen përmes sistemit të bursave, programit EPIC, etj. <i>Evidenca 3.13-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik 2023-2024;</i> <i>Evidenca 4.40-Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024;</i> <i>Evidenca 6.5 Rast i planit të masave të ndërmarra nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC;</i>

	<i>Evidenca 5.12-Rregullorja e bursave mbi zbritjen e tarifës vjetore të Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 4.14- Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;</i> <i>Evidenca 3.11-Udhëzimi për Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor;</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Nga dokumentacioni dhe intervistat e realizuara në institucion rezulton se NJSBC kryen vlerësime periodike të komponentëve të cilësisë përmes instrumenteve si pyetësorë të plotësuar nga studentët dhe personeli akademik. Gjithashtu, në institucion evidentohen disa forma të vlerësimit të drejtpërdrejtë, si pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në mbledhjet e departamenteve dhe një klimë që inkurajon shprehjen e lirë të mendimeve përmes takimeve individuale apo në grup me pedagogët.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të	GVJ vëren se institucioni realizon vlerësimet dhe matjen performancës, në mënyrë periodike përmes pyetësorëve të përcaktuar në paketën e instrumentave të cilësisë. Paketa përmban edhe një pyetësor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen. Ky pyetësor do të plotësohet në fund të semestrit nga studentët që përfundojnë për herë të parë këtë program studimi. Po ashtu, tre vjet pas përfundimit, pyetësori do të plotësohet edhe nga alumni. <i>Evidenca 6.2-Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i>

studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se WBU monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, me qëllim garantimin e arritjes së objektivave formuese dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tij. Procesi koordinohet dhe monitorohet nga NJSBC, mbi bazën e një plani vjetor veprimi. Në këto vlerësime do të përfshihen edhe studentët e diplomuar, si pjesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse. Për procesin e vlerësimit dhe monitorimit institucioni përdor kryesisht metoda të tërthorta por edhe forma të drejtpërdrejta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se strukturat kryesore përgjegjëse për SBC janë Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në të dyja këto struktura janë përfshirë ekspertë të jashtëm dhe të brendshëm dhe përfaqësues nga studentët. Konkretisht Komisioni përbëhet nga një përfaqësues nga secili fakultet, një përfaqësues i studentëve, një ekspert i jashtëm dhe dy përfaqësues nga personeli administrativ. NJSBC përbëhet nga nga një përfaqësues nga secili fakultet, një përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm. Kjo përbërje garanton gjithëpërfshirje në procesin SBC. <i>Evidenca 3.14-Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë;</i>

	<i>Evidenca 3.16-Vendimi për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC);</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në WBU Komisioni dhe NJSBC janë dy strukturat kryesore përgjegjëse për SBC. Komisioni është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë, ndërsa NJSBC përgjegjëse për kryerjen e proceseve monitoruese dhe vlerësuese periodike. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre dy organeve përcaktohen në rregulloret përkatëse të organizimit të tyre. Përbërja dhe kompetencat e NJSBC përcaktohen edhe në statutin e WBU, në nenet 37 dhe 38. NJSBC përdor paketën e instrumentave të cilësisë për monitorimin dhe vlerësimin, duke siguruar pjesëmarrje të gjerë të të gjithë aktorëve si personeli akademik, ndihmësakademik, administrativ, studentëve. <i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Western Balkans; Evidenca 3.15-Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e S;</i> <i>Evidenca 3.17-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC;</i> <i>Evidenca 6.2-Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se në Komision dhe NJSBC ka përfaqësues nga çdo njësi kryesore, personeli administrativ dhe përfaqësues nga Këshilli Studentor. Po ashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se në proceset e dokumentuara të sigurimit të cilësisë të analizuara në kriteret e mësipërme, janë të përfshirë student dhe anëtarë të njësisë bazë dhe njësisë kryesore. <i>Evidenca 3.14-Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë; Evidenca 3.16-Vendimi për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC);</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se në proceset e vlerësimit respektohet integriteti akademik, shmanget çdo lloj diskriminimi apo pabarazie, si dhe sigurohet gjithëpërfshirje. Referuar paketës së instrumentave të cilësisë, të gjithë aktorët e brendshëm janë objekt vlerësimi përfshirë, rektorin, dekanin, përgjegjës të departamentit dhe personelin. Zhvillimi i pyetësorëve është anonim dhe të dhënat përpunohen në mënyrë rigorozë. Rezultatet individuale shpërndahen në zart të mbyllur. <i>Evidenca 6.2-Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i>

Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstaton se në përbërje të Komisioni dhe NJSBC ka nga një ekspert të jashtëm të cilët japin mendime dhe ekspertizë lidhur me cilësinë e programeve të studimit dhe përmirësimin e tyre. Po ashtu, GVJ vëren se kontributi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm jepet edhe përmes veprimtarive të tjera si Panairi i Punës, trajnimet, marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione e biznese brenda dhe jashtë vendit, etj. <i>Evidenca 3.14-Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë; Evidenca 3.16-Vendimi për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC);</i>			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se njësitë bazë, njësitë kryesore, personeli akademik, personeli administrativ dhe studentët janë të përfshirë në procesin e SBC, duke kontribuar në arritjen e rezultateve dhe përmirësimin e proceseve akademike dhe administrative. Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre përcaktohen qartë në aktet e brendshme të institucionit. Në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit dhe NJSBC ka përfaqësues nga studentët dhe ekspertë të jashtëm.</i> <i>Angazhimi i ekspertëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm realizohet edhe përmes veprimtarive të tjera si trajnime, panairë, marrëveshje bashkëpunimi, praktika mësimore, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimeve të zhvilluara në institucion me grupe të ndryshme interesi, GVJ konstaton se personeli akademik, administrativ dhe studentët janë të njohur me politikat, strategjitë dhe veprimtaritë e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kuadri rregullator SBC është i

programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	aksesueshëm prej tyre. Në faqen web të institucionit ka një hapësirë të dedikuar për SBC (https://iqau.wbu.edu.al/) ku gjenden të publikuara veprimtaritë, instrumentat dhe raportet e vlerësimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit, vizitës në institucion dhe pas konsultimit të faqes së internetit, GVJ konstaton se raportet e vlerësimeve të prodhuara nga NJSBC janë të publikuara dhe është respektuar legjislacioni për të dhënat personale, liria dhe etika akademike të përcaktuara në statut, rregulloren themelore, kodin e etikës dhe rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Në takime GVJ u informua se rezultatet individuale të vlerësimit i shpërndahen personelit në zarf të mbyllur. <i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Western Balkans; Evidenca 1.2-Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i> <i>Evidenca 6.19-Kodi i Etikës për Stafin Akademik dhe Administrativ WBU;</i> <i>Evidenca 3.37. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Siç është evidentuar edhe në kriteret e mësipërme, rezultatet e vlerësimeve ndahen nga NJSBC me njësitë dhe organet vendimmarrëse dhe diskutohen në mbledhjet e tyre. Si rezultat i këtyre diskutimeve, hartojnë plane masash konkrete për adresimin e mangësive/problematikave të konstatuara. Strukturat drejtuese zhvillojnë gjithashtu trajnime bazuar në nevojat e identifikuara gjatë vlerësimeve. <i>Evidenca 1.16. Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2023-2024 dhe planifikimi i ri vjetor;</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të paraqitur si dhe pas vizitës në institucion, GVJ vëren se institucioni është sistematik në vlerësimin e programeve të studimit si dhe siguron gjithëpërfshirje të palëve. Raportet e hartuara nga NJSBC mbi bazën e të dhënave që mbledhen përfshijnë çdo program studimi, përfshirë programin e studimit Bachelor në "ShKIA", ku identifikohen nevojat për përmirësime, të cilat bëhen gjithashtu edhe pjesë e raporteve vjetore të njësisë bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin e studimit. GVJ vëren se WBU merr masa për adresimin e nevojave të identifikuara përmes hartimit, miratimit dhe ndjekjes së planit vjetor të masave. <i>Evidenca 6.4-Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik;</i>

	Evidenca 3.39-Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Departamentit Shkenca Kompjuterike dhe Inte; Evidenca 3.40-Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inova;			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se WBU organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët, si takime periodike, forume të hapura diskutimi, takime me studentë dhe departamentin, trajnime të ndryshme, publikime në faqen web, SMART-WBU, rrjete sociale, etj, me qëllim informimin, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e tyre në përmirësimin e programit të studimit. Evidenca 1.16. Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2023-2024 dhe planifikimi i ri vjetor; Evidenca 3.33-Lista e aktiviteteve të organizuara nga Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit; https://iqau.wbu.edu.al/;			
Konkluzione	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se WBU siguron transparencën e politikave dhe strategjive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke i bërë ato të aksesueshme për studentët dhe publikun përmes dokumenteve, faqes zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale. Rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit publikohen duke respektuar legjislacionin për të dhënat personale, integritetin dhe etikën akademike. Këto vlerësime shoqërohen me plane masash për përmirësim, të cilat ndiqen nga organet përgjegjëse. Institucioni monitoron dhe vlerëson ndikimin e këtyre masave në cilësinë e programeve të studimit, duke reflektuar përmirësime konkrete. Gjithashtu, GVJ konstatoi se në WBU organizohen veprimtari periodike me personelin dhe studentët për të rritur ndërgjegjësimin dhe angazhimin e tyre në sigurimin e cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni evidentohet për përkushtimin e tij në ndërkombëtarizim, përmes pjesëmarrjes aktive në panaire brenda dhe jashtë vendit, ofertës akademike tërheqëse në gjuhë të huaj, dhe krijimit të strukturave mbështetëse të dedikuara për studentët ndërkombëtarë (zyra të specializuara, shërbime të orientimit dhe integritetit etj);
2. Ambientet e mësimdhënies dhe mbështetjes akademike janë të pajisura me infrastrukturë, logjistikë dhe teknologji bashkëkohore dhe ofrojnë hapësira të bollshme e të sigurta për zhvillimin e veprimtarive akademike dhe studentore, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për studim dhe kërkim shkencor. Vlerësohet gjithashtu angazhimi për krijimin e kushteve të përshtatshme për personat me aftësi ndryshe;
3. Institucioni ka investuar ndjeshëm në mjediset laboratorike, duke ofruar një numër të konsiderueshëm laboratorësh të pajisur me infrastrukturë bashkëkohore, përfshirë pajisje hardware dhe mjete software të përshtatshme për lëndët e programit të studimit;
4. Institucioni ka ngritur struktura funksionale për menaxhimin akademik dhe administrativ, përfshirë Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, me politika dhe procedura të qarta e gjithëpërfshirëse. Vërehet gjithashtu një mbështetje e mirëorganizuar për studentët përmes Dekanatit të Studentëve dhe zyrave të ndryshme që ofrojnë shërbime të specializuara për ta;

b. Pika të dobta:

1. Lektorët e listuar në syllabus nuk janë gjithmonë me profil akademik në fushën përkatëse të lëndës; *(standarti IV.1, kriteri 1)*
2. Ka devijime ndërmjet emrave të lektorëve dhe/ose asistent-lektorëve në syllabus dhe atyre që realisht zhvillojnë mësimin; *(standarti IV.1, kriteri 1)*
3. Dokumentacioni i programit të studimit nuk është i plotë. Mungojnë CV-të e një pjese të stafit të angazhuar në programin e studimit; *(standarti IV.1, kriteri 1)*
4. Biblioteka ka një koleksion të kufizuar burimesh që i shërbejnë shkencave kompjuterike në përgjithësi dhe programit të studimit në veçanti; *(standarti IV.3, kriteri 1)*

Rekomandime:

1. Institucioni të përcaktojë dhe zbatojë një metodologji të unifikuar për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave mbi ngarkesën mësimore dhe angazhimin e stafit, duke siguruar përputhshmëri të plotë mes raportimeve të brendshme periodike, raportimeve zyrtare dhe dokumentacionit të programit të studimit;
2. Institucioni të sigurojë që lektorët e lëndëve të jenë të fushës përkatëse të lëndës, në përputhje me kërkesat akademike dhe natyrën e programit të studimit;



3. Institucioni të sigurojë që lektorët dhe/ose asistent-lektorët e përcaktuar në syllabus të angazhohen në zhvillimin e procesit mësimor, duke shmangur devijimet ndërmjet planifikimit dhe praktikës së përditshme;
4. Dokumentacioni i programit të studimit të përmbajë të gjitha CV-të e personelit të angazhuar në programin e studimit;
5. Biblioteka të pasurohet me literaturë që i shërben programit të studimit, duke u fokusuar fillimisht tek literatura e detyrueshme e specifikuar në syllabuset e lëndëve;
6. Institucioni të hartojë dhe të miratojë një procedurë të shkruar për përditësimin e fondit të bibliotekës, ku të përcaktohen qartë hapat, përgjegjësitë dhe afatet, si dhe të përpiqet që literatura e detyruar të jetë e disponueshme në bibliotekën e institucionit (fizike ose online);
7. Të rishikohet dhe harmonizohet rregullorja e programit të studimit Bachelor në “ShkIA” me planprogramin zyrtar dhe versionin e publikuar në faqen zyrtare të institucionit;
8. Institucioni të përfshijë në aktet e brendshme procedura të qarta dhe periodike për kontrollin dhe auditimin e brendshëm të strukturave administrative dhe të proceseve që lidhen me menaxhimin institucional, duke përfshirë sekretarinë mësimore, financën, etj;

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor Computer Sciences and Artificial Intelligence

a. Strengths and affirmations:

1. The institution stands out for its commitment to internationalization, through active participation in both domestic and international fairs, an attractive academic offer in foreign language, and the establishment of dedicated support structures for international students (specialized offices, orientation and integration services, etc.);
2. The teaching and academic support facilities are equipped with modern infrastructure, logistics, and technology, providing spacious and secure areas for academic and student activities, and creating an ideal environment for study and scientific research. The institution's efforts to ensure suitable conditions for individuals with disabilities are also highly valued;
3. The institution has made significant investments in laboratory facilities, providing a substantial number of labs equipped with modern infrastructure, including hardware and software tools tailored to the program's subjects;
4. The institution has established robust structures for academic and administrative management, including an Internal Quality Assurance System with clear, comprehensive policies and procedures. Additionally, there is well-organized support for students through the Student Dean's Office and various other offices that offer specialized services;

b. Weaknesses:


1. The lecturers listed in the syllabi do not always possess an academic profile aligned with the specific subject they teach; (*standard IV.1, criterion 1*)




2. There are discrepancies between the names of lecturers and assistant lecturers in the syllabi and those who actually perform the teaching; (*standard IV.1, criterion 1*)
3. The documentation of the study program is incomplete. CVs of some of the staff engaged in the study program are missing; (*standard IV.1, criterion 1*)
4. The library has a limited collection of resources serving computer sciences in general and the study program in particular; (*standard IV.3, criterion 1*)

Recommendation

1. The institution should establish and implement a unified methodology for collecting, processing, and reporting data on teaching load and staff engagement, ensuring full alignment between internal periodic reports, official reports, and program documentation;
2. The institution should ensure that course lecturers possess academic qualifications in the relevant subject area, in line with the program's academic requirements and structure;
3. The institution should verify that the lecturers and/or assistant lecturers named in the syllabi are the same individuals delivering the instruction, avoiding discrepancies between planning and actual teaching;
4. The study program documentation should include the CVs of all staff involved in the program;
5. The library should be enriched with literature and resources that supports the study program, with an initial focus on the mandatory literature specified in the course syllabi;
6. The institution should develop and approve a written procedure for updating the library's academic collection, clearly defining the steps, responsibilities, and timelines, and ensure that required literature are available in the institution's library (either physical or online);
7. The Bachelor program regulation in Computer Science and Artificial Intelligence should be reviewed and harmonized with the official curriculum and the version published on the institution's official website;
8. The institution should include in its internal acts clear and periodic procedures for the internal auditing and control of administrative structures and institutional management processes, including academic administration, finance, and others;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X